



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Prosvete, Nauke, Tehnologije i Inovacija
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË MËSIMDHËNËSVE

Vlerësimi për licencë të avancuar UDHËZUES PËR MËSIMDHËNËS

VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË MËSIMDHËNËSVE

**Vlerësimi për licencë të avancuar
UDHËZUES PËR MËSIMDHËNËS**

Shkurtesat

AF	Arsimi Fillor
AML	Arsimi i Mesëm i lartë
AMU	Arsimi i Mesëm i Ulet
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
IA	Inspektorati i Arsimit
ISCED	Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit
KB	Kurrikula Bërthamë
KKK	Korniza e Kurrikulës së Kosovës
KKK	Korniza Kurrikulare e Kosovës
KSZHM	Kornizë Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve
KSHLM	Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve
LA	Licencë e Avancuar
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
PLA	Provimi për Licencë të Avancuar
PSAK	Plani Strategjik për Arsim në Kosovë
UA	Udhëzim Administrativ
VPM	Vlerësimi i Performancës së Mësimdhënësve
ZHPBSH	Zhvillim Profesional me Bazë në Shkollë
ZHPM	Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

SHËNIM: Ky dokument bazohet në materialet e përgatitura nga Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) në Republikën e Shqipërisë. Përshatja e me kontekstin dhe specifikat e arsimit në Kosovë, është bërë me marrëveshje dhe në bashkëpunim me ekspertë nga ASCAP.

Tabela e përmbajtjes

Shkurtesat.....	2
Hyrje	4
1. Fushat e mësimdhënies, standardet, treguesit e performancës dhe përshkruesit e kompetencave për licencë të avancuar për mësimdhënie	7
2. Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve për licencë të avancuar për mësimdhënie	12
2.1. Provimi i licencës së avancuar për mësimdhënës	13
2.2. Vlerësimi i performancës për licencë të avancuar për mësimdhënës - i drejtuar nga Inspektorati i Arsimit.....	14
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e bartësve të procesit të VPM për licencë të avancuar ..	16
4. Përgatitja dhe organizimi i provimit për licencë të avancuar	19
4.1. Programet orientuese për organizimin e provimit për licencë të avancuar	20
4.2. Testet e provimit për licencë të avancuar	20
4.3. Administrimi i provimit për licencë të avancuar	21
4.4. Mjediset e provimit për licencë të avancuar.....	21
4.5. Rregullat e provimit për licencë të avancuar.....	22
4.6. Vlerësimi i provimit për licencë të avancuar.....	23
5. Përgatitjet dhe organizimi i vlerësimit të jashtëm të performancës së mësimdhënësve për licencë të avancuar	23
Shtojca të instrumenteve që përdoren nga Inspektorati i Arsimit	34
Shtojca B - Protokoli i Vëzhgimit në Klasë (PVK)	35
Shtojca C - Poentimi përfundimtar - raporti i vlerësimit të mësimdhënësit	43

Hyrje

Ky udhëzues është përgatitur nga MASHTI me qëllim që të informoj për politikat arsimore që e rregullojnë Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve (VPM), në mënyrë të veçantë vlerësimin e mësimdhënësve për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie.

Qasja e ndjekur në përgatitjen e këtij udhëzuesi, ka referencë hierarkinë e politikave arsimore që rregullojnë dhe lidhen me zhvillimin e mësimdhënësve në karrierë. Kjo qasje ka referencë tri politika arsimore më poshtë:

1. Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënies në Kosovë¹;
2. Udhëzimi Administrativ (UA) 14/2023 për sistemin e licencimit dhe karrierën në mësimdhënie²; dhe
3. Udhëzimi Administrativ (UA) 15/2023 për Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve³

Procesi i vlerësimit të performancës u ndihmon mësimdhënësve të reflektojnë mbi praktikën e tyre të mësimdhënies. Prandaj, sugjerojmë që së pari referojuni Kornizës Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënies në Kosovë (KSZHM) e cila përcakton fushat e mësimdhënies, standardet dhe treguesit e performancës, të cilat do të jenë referenca kryesore për përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit, mbështetjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve në shërbim, vlerësimin e performancës dhe promovimin e karrierës për mësimdhënës.

Sipas Kornizës, për secilin standard të profesionit të mësimdhënësit, fushat e mësimdhënies ofrojnë një ilustrim më të detajuar të vlerave të synuara të mësimdhënies, njohurive, praktikave, të nxënies dhe angazhimit. Këto fusha përshkruajnë dhe identifikojnë komponentët e të nxënies cilësor për secilën fazë të karrierës së mësimdhënësve në Kosovë. Një mësimdhënës efektiv është në gjendje të integrojë dhe zbatojë njohuritë, praktikën dhe angazhimin profesional, në mënyrë që të krijojë një mjedis mësimi në të cilin të nxënies vlerësohen në mënyrë të efektshme.

Referenca e dytë për këtë udhëzues është *UA14/2023 për sistemin e licencimit dhe karrierën në mësimdhënie*. Sipas Nenit 8 të këtij UA, për licencë të avancuar për mësimdhënie, mësimdhënësit duhet ti plotësojnë kushtet e përvojës – 8 vite përvojë, të përfundojnë së paku 200 orë zhvillim profesional, si dhe të përfundojnë me sukses provimin kualifikues për licencë të avancuar, sipas kritereve dhe kushteve të përcaktuara nga MASHTI.

Referenca e tretë për këtë udhëzues është *UA 15/2023 për Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve*. Sipas Nenit 5 të këtij UA, vlerësimi i performancës së mësimdhënësve që kanë aplikuar marrjen e licencës së avancuar në mësimdhënie, përfshin provimin - vlerësimin me shkrim të organizuar nga Ministria e Arsimit dhe vlerësimin e jashtëm nga Inspektorati i Arsimit (IA).

1 <https://masht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/05/kornize-strategjike.pdf>

2 UA 14/2023 për sistemin e licencimit dhe karrierën në mësimdhënie: <https://masht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/06/Udhëzim-administrativ-me-nr-14-rotated-1.pdf>

3 UA 15/2023 për Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve <https://masht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/06/Udhëzimi-administrativ-me-nr-15-rotated-1.pdf>

Nevojat dhe përfitimet nga zbatimi i sistemit të avancimit të mësimdhënësve në Kosovë

Sistemi i licencimit në arsim synohet të bëhet një sistem që fuqizon një dimension të aspiratës për cilësi në shkollat kosovare. Kështu procesi i licencimit për shkallët më të larta të licencës për mësimdhënës, me theks të veçantë për licencë të avancuar në mësimdhënie, synohet të bëhet një proces garues i cili në vete përfshin doemos statusin, meritën, performancën, dhe cilësinë.

Arsyet përse janë duke u zhvilluar përgatitjet për fillimin e zbatimit të një sistemi të avancimit të mësimdhënësve në sistemin arsimor në Kosovë janë të shumta, në radhë të parë ato burojnë nga përpjekjet institucionale për vendosjen e standardit të llogaridhënies, motivimit dhe dallimit midis mësimdhënësve të mirë/përkushtuar dhe më pak të mirë/përkushtuar.

Arsyet për zbatimin e një sistemi të avancimit të mësimdhënësve në sistemin arsimor në Kosovë lidhen me disa nga nevojat në vijim:

- Nevoja për përmirësim të cilësisë;
- Nevoja për kompensim-shpërblim të mësimdhënësve të bazuar në meritë;
- Nevoja për krijimin e masës kritike për cilësi;
- Nevoja për ta bërë të kuptimshëm procesin e licencimit në arsim;
- Nevoja për ta bërë të kuptimshëm sistemin e zhvillimit profesional; dhe
- Depolitizimi i arsimit.

Adresimi i nevojave të lartpërmendura kërkon vendosjen e një sistemi të institucionalizuar të avancimit të mësimdhënësve, sigurimin e kushteve dhe mbështetjen e nevojshme për zbatimin e tij. Hapi i parë në jetësimin e këtij sistemi është zhvillimi i të gjitha materialeve mbështetëse të cilat e ndihmojnë këtë sistem që të bëhet i zbatueshëm, praktik, i udhëhequr me profesionalizëm dhe i bazuar në parimet bazë të procedurave për organizimin e procesit të avancimit të mësimdhënësve. Kjo nënkupton ndërlikdhjen e sistemit të licencimit të mësimdhënësve me synimet për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë.

Përfitimet nga avancimi i mësimdhënësve në licencë të avancuar

Përfitimet nga avancimi i mësimdhënësve në licencë të avancuar janë të shumta. Nga ky proces përfitues janë sistemi arsimor, komuniteti i mësimdhënësve dhe shkolla. Mësimdhënësit e avancuar (por edhe ata me licencë të përhershme) mund të jenë të rëndësishëm për sistemin e arsimit në shumë mënyra. Ata mund të bëhen agjentë të ndryshimit dhe shëmbëlltyrë e punës cilësore e cila ndihmon në përmirësimin e cilësisë në arsim, e cila reflektohet mjaft kritike në të gjitha vlerësimet ndërkombëtare.

Mësimdhënësit nga avancimi në licencë të avancuar përfitojnë shumë, në radhë të parë shpërblehen për punën meritore që bëjnë, duke u përfshirë në ngritje të pagës në bazë të koeficientit të përcaktuar sipas Rregullores (QRK) nr. 01/2023 për shtesën për licencë të avancuar për nëpunësin e arsimit parauniversitar. Në radhë të dytë, mësimdhënësit e avancuar marrin statutin e merituar i cili reflektohet në imazhin e punës së tyre me nxënës.

Mësimdhënësit e avancuar mund të kryejnë funksione të shumta në interes të zhvillimit të performancës së shkollës. Ata / ato mund të kryejnë funksionet në vijim:

- Kryetarë të aktiveve profesionale në shkollë – departamenteve (licenca e avancuar – Licenca e Avancuar (LA) - mund të jepte përparësi për emërim)
- Koordinatorë të cilësisë (LA si përparësi për emërim)
- Drejtorë / zëvendësdrejtorë të shkollave (LA si përparësi për zgjedhje)
- Udhëheqës të grupeve punuese në shkolla (LA si përparësi për caktim)
- Ekspertë për kurrikula, recensentë të teksteve shkollore, anëtarë të ekipeve të ndryshme profesionale (në nivel vendor dhe qendror), anëtarë të grupeve për planifikim zhvillimor (në të gjitha nivelet), ku LA mund të ishte kusht për emërim.

Qëllimet e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie

Për licencën e avancuar për mësimdhënie, aftësitë e kërkuara përqendrohen në zotërimin mjesh tërësor të përmbajtjes lëndore, dhe demonstrimin e ekspertizës në një spektër të gjerë të shkathësisë pedagogjike, metodologjive dhe teknikave mësimore, vlerësimin e nxënësve dhe shfrytëzimin e rezultateve të vlerësimit për t'ia përshtatur mësimdhënien nxënësve, demonstrimin e një motivimi të lartë të nxënësve dhe rezultate pozitive të vlerësimit dhe ngritjes, punën ekipore me kolegët, me aktivitetet profesionale, me prindërit dhe me komunitetin.

Qëllimet kryesore të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie janë:

- Të sigurohemi se nxënësit përfitojnë nga shkolla në të cilën punojnë mësimdhënës që janë të përkushtuar për përmirësim të cilësisë në mësimdhënie dhe këtë përkushtim e tregojnë me rezultatet e tyre të punës;
- Të vendosim një sistem të institucionalizuar të avancimit të mësimdhënësve i cili krijon kushte për një garë për cilësi në arsim dhe për kompensim të bazuar në meritë;
- Të nxisim zhvillimin dhe avancimin profesional të mësimdhënësve.

Një sistem i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie duhet të jetë sa më i strukturuar, i bazuar në kritere dhe procedura që i shtrohen një analize kritike të vazhdueshme që ndihmojnë të ketë plotësim dhe ndryshime që mundësojnë vlerësim të drejtë, efektiv dhe të krahasueshëm të performancës së çdo mësimdhënësi aplikues për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie. Këtij qëllimi i shërben edhe ky udhëzues si një dokument dinamik, i cili në fazën e caktuar plotësohet dhe ndryshohet nga praktika të mira.

Udhëzuesi do të jetë një mjet ndihmës drejt funksionalizimit të një sistemi koherent, transparent dhe të standardizuar në nivel vendi për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie. Për çështje praktike, udhëzuesi është i ndarë në gjashtë pjesë.

- **Në pjesën e parë** do të gjeni prezantimin e fushave dhe standardeve të mësimdhënies, treguesit e performancës dhe profilin e kompetencave për mësimdhënësit, të përcaktuara me Kornizën Strategjike për licencë të avancuar (LA);
- **Në pjesën e dytë** do të gjeni një përshkrim të sistemit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve për licencë të avancuar për mësimdhënie;
- **Në pjesën e tretë** përshkruhen detyrat e institucioneve përgjegjëse dhe kandidatëve për LA;

- Në pjesën e katërt dhe të pestë përshkruhet organizimi i provimit për LA dhe organizimi i vlerësimit të performancës për licencë të avancuar nga inspektorati i arsimit; dhe
- Në pjesën e gjashtë prezantohet Protokollin e Vëzhgimit në Klasë (PVK) që përdoren nga Inspektorati i Arsimit për vlerësim të jashtëm të mësimitdhënësve për Licencë të avancuar.

1. Fushat e mësimitdhënies, standardet, treguesit e performancës dhe përshkruesit e kompetencave për licencë të avancuar për mësimitdhënie

Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimitdhënies në Kosovë (KSZHM), është dokument referues për sistemin e vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve, ku përfshihet edhe vlerësimi për licencë të avancuar për mësimitdhënie, paraqet një strukturë hierarkike që përbëhet nga:

- Fushat e mësimitdhënies – janë fushat kryesore të zhvillimit të mësimitdhënësve në karrierë mbi të cilat organizohen standardet e profesionit të mësimitdhënësit, treguesit e performancës dhe kompetencat specifike të mësimitdhënësve për secilën licencë të karrierës së mësimitdhënësve;
- Standardet e profesionit - janë përshkrues (deskriptorë) të profesionit të mësimitdhënësit;
- Treguesit e performancës - paraqesin përshkrime të njohurive, të shprehive dhe të shkathtësive që kërkohen për përmbushjen e një standardi të caktuar dhe shërbejnë për specifikimin e kompetencave për secilën licencë të karrierës së mësimitdhënësve;
- Kompetencat e mësimitdhënësve për licencë të avancuar për mësimitdhënie - paraqesin përshkrime të njohurive, të shprehive dhe të shkathtësive që kërkohen për përmbushjen e një standardi të caktuar nga mësimitdhënësit që synojnë licencën e avancuar në mësimitdhënie.

Tabela në vijim paraqet strukturën hierarkike të përshkrimeve më sipër, sipas përcaktimeve në dokumentin e KSZHM, e cila ka përdorim shumëdimensional në procesin e vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve për marrjen e licencës së avancuar.

Fushat	Standardet	Treguesit e performancës	Kompetencat e mësimitdhënësve për licencë të avancuar për mësimitdhënie
Vlerat profesionale, qëndrimet dhe sjelljet	1. Njeh dhe i mbështet vlerat dhe kriteret kryesore që janë vendosur nga MASHTI/ Përgjegjësi karshi detyrimeve dhe obligimeve të punës.	1.1. Merr për bazë praktikën e mësimitdhënies në vlerat dhe parimet e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe në kodin e mirësjelljes të MASHTI	I respekton parimet kryesore të përshkruara në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës dhe kodin e mirësjelljes së MASHTI të themeluar nga autoritete rregulluese, sisteme dhe shkolla dhe i kupton implikimet e politikave dhe proceseve relevante ligjore, administrative dhe organizative: <ul style="list-style-type: none"> • Respekton orarin e punës
		1.2. I kryen detyrat dhe obligimet e mësimitdhënies me profesionalizëm, përkushtim të lartë, ndershmeri dhe saktësi	

<p>Njohuritë profesionale dhe të kuptuarit</p>		1.3. E njeh dhe i respekton kërkesat ligjore, administrative dhe organizative të profesionit, duke e përfshirë orarin mësimor, menaxhimin e kohës	<ul style="list-style-type: none"> • Kujdeset dhe ruan pronën e shkollës, si dhe e mirëmban një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm mësimor • Respekton detyrat dhe obligimet e punës • Ruan në nivel të lartë besimin dhe konfidencialitetin profesional
	2. .Demonstron qëndrime dhe sjellje pozitive dhe objektive për mirëqenien e nxënësve dhe mësimit.	2.1. E kupton zhvillimin fizik, social dhe intelektual të nxënësve dhe e promovon mësimin gjatë gjithë jetës.	<ul style="list-style-type: none"> • Demonstron një repertoar efektiv dhe fleksibil strategji të mësimdhënies dhe të vlerësimit në bazë të njohjes së karakteristikave fizike, shoqërore dhe intelektuale të të gjithë nxënësve, duke i përfshirë edhe nxënësit me nevoja të veçanta
		2.2. I njeh nxënësit se si mësojnë, si dhe i përkrah në arritjen e rezultateve mësimore	<p>Demonstron një repertoar të gjerë të strategjive të mësimdhënies që e maksimalizojnë nxënien e nxënësve dhe ia përshtatë strategjitë e mësimdhënies nevojave të nxënësve duke:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorur teknika të shumëfishta për pjesëmarrjen aktive të nxënësve në procesin e mësimit dhe duke i demonstruar suksesin në arritjet e nxënësve në të gjitha nivelet; • Krijuar një mjedis, i cili e <i>maksimizon</i> mësimin dhe shfrytëzon strategji të ndryshme të mësimdhënies që u përshtatet nevojave individuale të nxënësve
		2.3. I trajton të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë dhe me respekt	<ul style="list-style-type: none"> • E zgjeron repertorin e strategjive mësimore që janë të përgjegjshme sa i përket përparësive dhe nevojave të nxënësve nga grupet e ndryshme gjuhësore, kulturore, fetare dhe shoqërore-ekonomike

	2.4. Krijon mjedis të sigurt dhe mbështetës mësimor, që e maksimizon nxënien dhe i inkurajon nxënësi që të bëhen persona që i zgjidhin problemet, që janë vendimmarrës, që mësojnë gjatë tërë jetës, si dhe që bëhen pjesëtarë të dobishëm të shoqërisë	<ul style="list-style-type: none"> • I zgjeron njohuritë e teknikave efektive për inkurajimin e mendimit të nivelit të lartë dhe të mësimin gjatë gjithë jetës, duke përfshirë mundësi për nxënës që t'i praktikojnë njohuritë e tyre në mënyrë të pavarur
3. Demonstron njohje të kurrikulës/ përmbajtjes lëndore dhe metodikës së didaktikës profesionale të lëndës.	3.1. E njeh përmbajtjen e fushës mësimore në kurrikulën e Kosovës	<ul style="list-style-type: none"> • Demonstron njohje të përgjithshme të përmbajtjes dhe i realizon programet mësimore që promovojnë suksesin e nxënësve në nxënien e koncepteve dhe përmbajtjes së kurrikulës
	3.2. Di si ta jep mësim për përmbajtjen mësimore, duke shfrytëzuar teknika të ndryshme efektive	<ul style="list-style-type: none"> • Demonstron praktikë inovative në përzgjedhjen dhe organizimin e përmbajtjes, teknikave të mësimdhënies dhe ofrimit të programeve të mësim-nxënies dhe mësimdhënies
	3.3. Bën mësimdhënie të diferencuar për ta mbështetur pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve, si dhe për t'i trajtuar nevojat e veçanta mësimore të nxënësve me aftësi të ndryshme	<ul style="list-style-type: none"> • Demonstron praktikë efektive në strategjitë e mësimdhënies gjithëpërfshirëse, që trajtojnë nevojat e tyre të veçanta mësimore dhe sjellin sukses tek të gjithë nxënësit
	3.4. Zotëron strategji të ndryshme për menaxhimin e klasës	<ul style="list-style-type: none"> • Demonstron një repertor të strategjive për menaxhimin e klasës për t'u siguruar që nxënësit të angazhohen në aktivitetet e krijuara për ta, dhe që çështjet disiplinore të trajtohen me kujdes, drejt dhe me respekt të plotë

Shkathtësitë dhe praktika profesionale	4. Planifikon zbatim efektiv të mësim-dhënies dhe mësim-nxënies.	4.1. Përcakton qëllime sfiduese të mësimin	<ul style="list-style-type: none"> • Krijon një kulturë të pritjeve të larta për të gjithë nxënësit duke përcaktuar qëllime sfiduese
		4.2. Përdor strategji të llojllojshme të mësimdhënies për t'i motivuar nxënësit dhe nxisë të menduarit e nivelit të lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Shfrytëzon njohuritë aktuale dhe gjithëpërfshirëse për përmbajtjen dhe strategjitë përkatëse të mësimdhënies për zhvillimin dhe realizimin e programeve të cilësisë së lartë të mësim-nxënies dhe mësimdhënies
		4.3. I përzgjedh dhe i shfrytëzon burimet e duhura; Krijon materiale mësimore për temat e caktuara ku mungon literatura	<ul style="list-style-type: none"> • Krijon, përzgjedh dhe shfrytëzon një spektër të gjerë të burimeve, duke përfshirë TIK-un, për t'i angazhuar nxënësit në mësim
		4.4. Përdor teknologji adekuate në mënyrë adekuate – sigurt, me përgjegjësi dhe me etikë	<ul style="list-style-type: none"> • Demonstron strategji fleksibile në inkorporimin e teknologjisë në aktivitetet mësimore dhe shfrytëzimin etik të TIK-ut në procesin e mësim-nxënies dhe mësimdhënies
	5. Planifikon vlerësimin e vazhdueshëm (vlerësimin për të mësuar), ofron komente kthyesë dhe raporton sa i përket mësimin të nxënësve.	5.1. E vlerëson vazhdimisht progresin e nxënësve si dhe komunikon shpesh me nxënësit për t'iu ofruar informata kthyesë në mënyrë konstruktive	<ul style="list-style-type: none"> • Krijon dhe aplikon strategji të ndryshme të vlerësimin për diagnostikimin e nevojave mësimore • Planifikon plotësimin e të arriturave të nxënësve në bazë të analizës së të arriturave të përgjithshme të nxënësit
		5.2. Planifikon plotësimin e zbrazëtive të të arriturat e nxënësve	
		5.3. I interpreton të dhënat nga vlerësimi i nxënësve për të përmirësuar nxënien e tyre	<ul style="list-style-type: none"> • I shfrytëzon të dhënat mjeshhtërisht nga vlerësimet e brendshme dhe të jashtme të nxënësve për ta vlerësuar procesin e mësim-nxënies dhe mësimdhënies, identifikimi i intervenimeve dhe modifikimi i mësimdhënies
		5.4. Raporton arritjet e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> • Harton raporte të sakta, informuese dhe me kohë për informimin e nxënësve dhe të prindërve/ kujdestarëve lidhur me suksesin e arritur të nxënësve në mësim për përmirësimin e nxënies së tyre

Mësimi dhe angazhimi profesional	6. Angazhohet për zhvillim të vazhdueshëm profesional.	6.1. I identifikon dhe i planifikon nevojat profesionale për mësim	<ul style="list-style-type: none"> Identifikon nevojat profesionale individuale për planifikimin e qëllimeve për zhvillim profesional duke përdorur burimet në dispozicion
		6.2. Përdor mësim të ri profesional për ta përmirësuar praktikën e mësimdhënies	<ul style="list-style-type: none"> Planifikon për mësim profesional duke iu qasur dhe kritikuar hulumtimet relevante, angazhohet në mundësi të cilësisë së lartë për ta përmirësuar praktikën e mësimdhënies.
		6.3. Angazhohet me kolegë për ta përmirësuar praktikën e mësimdhënies	<ul style="list-style-type: none"> Nis dhe angazhohet në diskutime profesionale me kolegë në forma të ndryshme për dhënien e këshillave dhe vlerësimin e praktikës me qëllim të përmirësimit të njohurive profesionale dhe të mësimdhënies.
		6.4. I përshtat dhe i përmirëson praktikën e mësimdhënies përmes nxënies dhe reflektimit	<ul style="list-style-type: none"> Kryen hulumtime në veprim dhe rregullisht shfrytëzon informatat kthyes nga të dhënat e nxënësve, kolegëve, dhe mbikëqyrësve për ta përshtatur praktikën mësimore.
	7. Angazhohet profesiona-lisht me kolegë, prindër dhe bashkësi.	7.1. Angazhohet për të krijuar mjedis bashkëpunues me kolegë	<ul style="list-style-type: none"> Nis dhe angazhohet në diskutime profesionale me ekipe me bazë në shkollë për vlerësimin e praktikës së mësimdhënies me qëllim të përmirësimit të njohurive profesionale dhe të praktikës së mësimdhënies, si dhe të rezultateve mësimore të nxënësve.
		7.2. Komunikon në mënyrë efektive me nxënës, prindër/ kujdestarë dhe kolegë	<ul style="list-style-type: none"> Krijon dhe ruan komunikim të vazhdueshëm të dyanshëm me prindërit / kujdestarët, duke e inkurajuar pjesëmarrjen e tyre në arsimimin e fëmijëve të tyre.

	<p>7.3. Angazhohet me rrjete të ndryshme profesionale të bashkëpunimit në fushën e mësimdhënies si dhe në bashkësi më të gjera profesionale dhe i promovon njohuritë si dhe debaton për problemet relevante të fushës së arsimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kontribuon në rrjetet dhe asociacionet profesionale dhe krijon lidhje produktive me shkollën dhe komunitetin e gjerë me qëllim të përmirësimit të mësimdhënies dhe nxënies - Këtu përfshihet edhe kontakti me ekspert të profesioneve të tjera (p.sh. psikologë), dhe me institucione të tjera arsimore, si biblioteka e muze, etj.
	<p>7.4. Ndërmerr hulumtime në veprim në mjedisin shkollor ku vepron</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërmerr hulumtimin në veprim për një problematikë të identifikuar në klasë. Shkruan raportin me të gjeturat e hulumtimit dhe i ndan me kolegët në shkollë;

Struktura e përshkrimeve të tabelës më sipër, në raport me procesin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve për marrjen e licencës së avancuar në mësimdhënie, gjeten përdorim në specifikimin e fushave kryesore të zhvillimit profesional, kompetencat profesionale dhe rezultatet e pritshme, si dhe udhëzimet bazë për:

- Provimin e kualifikimit për marrjen e licencës së avancuar në mësimdhënie; dhe
- Protokollin e vlerësimit nga Inspektorati i Arsimit .

Struktura e përshkrimeve të tabelës më sipër janë pika referuese për përgatitjen profesionale dhe plotësimin e kërkesave për zhvillimin profesional të mësimdhënësve nga programet e aprovuara nga MASHTI dhe nga aktivitetet e Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve me bazë në Shkollë (ZHPMBSH).

2. Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve për licencë të avancuar për mësimdhënie

Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve (VPM) për licencë të avancuar për mësimdhënie, është pjesë e sistemit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve i cili në mbështetje të Ligjit për Arsim Parauniversitar, është i rregulluar me dy udhëzime administrative: (i) UA 14/2023 për sistemin e licencimit dhe karrierën në mësimdhënie; dhe (ii) UA 15/2023 për Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve. Njohja e sistemit të VPM, specifikisht e pjesës për licencë të avancuar për mësimdhënie, në radhë të parë siguron transparencë për procesin e vlerësimit, si dhe zbatim të një qasje standarde dhe të bazuar në kritere dhe procedura të qarta.

Vlerësimi i performancës së mësimitdhënësve për licencë të avancuar në mësimitdhënie përbëhet nga:

- provimi kualifikues - provimi i licencës së avancuar për mësimitdhënës; dhe
- procesi i vlerësimit të drejtuar nga Inspektorati i Arsimit.

2.1. Provimi i licencës së avancuar për mësimitdhënës

Provimi i licencës së avancuar për mësimitdhënës e organizon MASHTI. Me këtë provim vlerësohen njohuritë e kandidatëve lidhur me lëndën/fushën e kualifikimit, si dhe aspekti pedagogjik e didaktik i punës së kandidatit. Mbi bazën e përgjegjësive që ka MASHTI, ka përcaktuar që provimi për licencë të avancuar të organizohet në gjashtë fusha kryesore të zhvillimit profesional të përcaktuara për verifikim përmes testit me shkrim i cili do të ketë gjithsej 70 pikë. Fushat kryesore janë:

- dokumentacioni zyrtar shkollor, i cili ka të bëjë me veprimtarinë edukative-arsimore të mësimitdhënësve në shkollë;
- kurrikula – programet e të gjitha lëndëve të arsimit fillor, nga klasa e parë në të pestën;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë së mësimitdhënies dhe vlerësimit, si dhe përdorimit të TIK-ut në procesin e mësimitdhënies dhe të nxënies në arsimin fillor;
- gjithëpërfshirja dhe etika në profesion;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës/ve të arsimit fillor, nga klasa e parë në të pestën.

Testi vlerësues për provimin e licencës së avancuar për mësimitdhënës përfshin kërkesa/pyetje në të gjitha fushat e zhvillimit profesional, të cilat janë të organizuara në dy pjesë, të cilat së bashku mundësojnë grumbullimin e 70 pikëve të totalit të testit. Detajet e fushave të zhvillimit profesional për të cilat hartohen kërkesa/pyetje, % dhe numri i pikëve të testit për secilën fushë, dhe pikë minimale pjesët e provimit, prezentohen në tabelën vijuese.

Fushat e zhvillimit profesional		%	Nr. i pikëve të testit	Pikët minimale
Pjesa e parë	Dokumentacioni zyrtar shkollor	Rreth 6%	4	24 pikë 80%
	Kurrikula - Programi lëndor	Rreth 9%	6	
	Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë	Rreth 18%	13	
	Aspekte të gjithëpërfshirjes dhe etika në profesion	Rreth 4%	3	
	Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Rreth 6%	4	
	Totali pjesa e parë	(43%)	30	
Pjesa e dytë	Përmbajtja shkencore e lëndës	Rreth 57%	40	32 pikë 80%
TOTALI I PIKËVE		(100%)	70	56 pikë 80%

Udhëzime dhe orientime të veçanta për strukturën dhe përmbajtjen e Provimit për licencë të avancuar për mësimdhënës, prezentohen në tri programet orientuese të zhvillimit profesional të mësimdhënësve në sistemin e arsimit parauniversitar, të miratuara nga MASHTI për vitin 2024:

1. Programi i orientues për marrjen e licencës së avancuar për **Mësues të arsimit fillor**;
2. Programi i orientues për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie – **Mësimdhënës të lëndës “Gjuhë shqipe”** të arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë; dhe
3. Programi i orientues për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie – **Mësimdhënës të lëndës “Matematikë”** të arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë.

Në pjesën e pestë të këtij udhëzuesi janë dhënë orientime dhe udhëzime më specifike për organizimin e provimit për licencë të avancuar.

2.2. Vlerësimi i performancës për licencë të avancuar për mësimdhënës - i drejtuar nga Inspektorati i Arsimit

Pjesa tjetër e VPM, e përcaktuar me UA 14/2023 si vlerësim i jashtëm i drejtuar nga IA. Në këtë pjesë të vlerësimit përfshihen kandidatët të cilët e përfundojnë me sukses provimin kualifikues për licencë të avancuar.

VPM për licencë të avancuar i drejtuar nga IA, përfshin vlerësimin e portfolios profesionale dhe vlerësimin e njësisë mësimore në praktikën e punës me nxënës.

Vlerësimi nga Inspektorati i Arsimit	%	Nr. i pikëve të vlerësimit	Pikët minimale
Vlerësimi i portfolios profesionale	Rreth 42%	12.5 pikë	24 pikë 80%
Vlerësimi i orës mësimore	Rreth 58%	17.5 pikë	
Gjithsej	100%	30	

Vlerësimi i portfolios së kandidatit/es

Referuar UA 14/2023, mësimdhënësit për procesin e marrjes së licencës së avancuar përgatisin portfolio me dëshmi për punën dhe të arriturat personale profesionale në karrierë si mësimdhënës dhe në raport me demonstrimin e zotërimit të standardeve të përcaktuara për këtë nivel të karrierës.

Portfolio duhet të jetë personale dhe në gjendje të komunikojë një pasqyrë të gjithmbarshme të punës së mësimdhënësit/kandidatit. Për qëllime të licencës së avancuar, mësimdhënësi përgatit portfolion me dokumentacion të strukturuar. Sugjerohet të përfshihet një tabelë e përmbajtjes që sqaron materialet apo dokumentet e punës të vendosura në portfolio.

Vlerësimi i portfolios së kandidatit/es përfshin rreth 42% apo 12.5 pikë të totalit prej 30 pikëve nga VPM i drejtuar nga Inspektorati i arsimit. Formati i portfolios duhet të përmbajë dokumente personale dhe profesionale të kandidatit/es që synon marrjen e licencës së avancuar. Në vlerësim përfshihet pjesa

profesionale e portfolios. Detajet e dokumenteve të portfolios profesionale dhe mënyra e vlerësimit specifikohen në pjesën: *Përgatitjet dhe organizimi i vlerësimit të performancës* për licencë të avancuar nga Inspektorati i Arsimit.

Vlerësimi i orës së mësimore

Vlerësimi i orës mësimore për licencë të avancuar realizohet nga Inspektorati i Arsimit. Bëhet në mbështetje të protokollit për vëzhgim të orës mësimore në klasë, i cili përfshin shtatë dimensione:

- Dimensioani 1: Klima pozitive në klasë
- Dimensioani 2: Menaxhimi i kohës
- Dimensioani 3: Angazhimi i nxënësve në aktivitetet mësimore
- Dimensioani 4: Strukturimi i situatave mësimore kuptimplota
- Dimensioani 5: Zhvillimi i të kuptuarit të nxënësve
- Dimensioani 6: Vlerësimi i kuptimit të nxënësve
- Dimensioani 7: Zhvillimi i autonomisë.

Vlerësimi i orës mësimore bëhet për secilin dimension. Vlerësimi i orës mësimore përfshin rreth 58% apo 17.5 pikë të totali prej 30 pikëve nga VPM i drejtuar nga Inspektorati i arsimit. Detajet e Protokollit i Vëzhgimit në Klasë (PVK) dhe të vlerësimit bazuar në kërkesat/pritshmëritë për mësimdhënës për secilin dimension, specifikohen në pjesën: *Përgatitjet dhe organizimi i vlerësimit të performancës* për licencë të avancuar nga Inspektorati i Arsimit.

Pikët përmbledhëse nga dy proceset e vlerësimit për licencë të avancuar

Siç është përshkruar më sipër, një kandidat për marrjen e licencës së avancuar u nënshtrohet dy proceseve të vlerësimit të jashtëm. Nga të dy proceset e vlerësimit një kandidat duhet të ketë minimumin e pikëve nga provimi kualifikues - provimi i licencës së avancuar për mësimdhënës dhe procesi i VPM i drejtuar nga Inspektorati i Arsimit, siç prezentohet në tabelën përmbledhëse të pikëve të vlerësimit.

	Fushat e zhvillimit profesional	%	Nr. i pikëve të testit	Pikët minimale
Pjesa e parë	Dokumentacioni zyrtar shkollor	Rreth 6%	4	24 pikë / 80%
	Kurrikula - Programi lëndor	Rreth 9%	6	
	Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë	Rreth 18%	13	
	Aspekte të gjithëpërfshirjes dhe etika në profesion	Rreth 4%	3	
	Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Rreth 6%	4	
	Totali pjesa e parë	(43%)	30 pikë	
Pjesa e dytë	Përmbajtja shkencore e lëndës	Rreth 57%	40 pikë	32 pikë / 80%

Totali i pikëve nga provimi	(100%)	70 pikë	56 pikë /80%
Vlerësimi nga Inspektorati i Arsimit (IA)	%	Nr. i pikëve të vlerësimit	Pikët minimale
Vlerësimi i portfolios profesionale	Rreth 42%	12.5 pikë	24 pikë 80%
Vlerësimi i orës mësimore	Rreth 58%	17.5 pikë	
Totali i pikëve nga vlerësimi i IA	(100%)	30 pikë	
Totali i pikëve nga provimi dhe VPM i drejtuar nga IA	(100%)	100 pikë	80 pikë / 80%

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e bartësve të procesit të VPM për licencë të avancuar

Bartësit e procesit të vlerësimi të performancës janë:

- Ministria;
- Inspektorati i Arsimit;
- Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA);
- Drejtori i shkollës;
- Mësimdhënësi.

Detyrat dhe përgjegjësitë e bartësve të procesit të VPM për licencë të avancuar burojnë nga Udhëzimet administrative (UA 14/2023 dhe UA 15/2023), përgjegjësitë institucionale dhe nga pakoja e dokumenteve të zhvilluara për procesin VPM për licencë të avancuar.

Përgjegjësitë e Ministrisë:

MASHTI së bashku me mekanizmat e themeluar për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve për licencë të avancuar kryen detyrat e mëposhtme:

- miraton politikat arsimore dhe dokumentet tjera që lidhen me zhvillimin në karrierë dhe vlerësimin e performancës **së mësimdhënësve për licencë të avancuar;**
- përcakton koeficientin e ngritjes në pagë për mësimdhënësit që marrin licencë të avancuar, sipas Rregulloren (QRK) nr. 01/2023 për shtesën për licencë të avancuar për nëpunësin e arsimit parauniversitar;
- harton programet orientuese për provimin për licencë të avancuar;
- cakton formatin e provimit për licencë të avancuar;
- cakton procedurat e aplikimit të kandidatëve/mësimdhënësve për hyrje në PLA;
- bën informim për pakon e vlerësimit për licencë të avancuar;

- cakton hartuesit e fondit të pyetjeve/kërkesave, hartuesit dhe vlerësuesit e testeve;
- themelon ekipet e veçanta për zhvillimin e materialeve mbështetëse dhe të komisioneve mbikëqyrëse për organizimin dhe koordinimin e provimit për licencë të avancuar;
- organizon seanca informimi dhe trajnime me hartuesit e fondit të pyetjeve, hartuesit e testeve, vlerësuesit e testeve si dhe me përgjegjësit e administrimit të provimit;
- harton formatet e procesverbaleve të parashikuara që lidhen me provimin për licencë të avancuar;
- përcakton mjediset ku do të zhvillohen provimet për licencë të avancuar;
- cakton numrin e kandidatëve në provim sipas mjediseve përkatëse;
- përcakton kriteret e vlerësimit me pikë të kërkesave të testit dhe të pjesëve të tij;
- monitoron procesin e organizimit të provimeve;
- harton databazën përfundimtare për të gjithë kandidatët në procesin e provimit për licencë të avancuar;
- harton raportin e ecurisë së procesit të provimit për licencë të avancuar;
- në koordinim me Inspektoratin e Arsimit dhe DKA-të, ndërmer masa për përmirësim të gjendjes në fushën e mësimdhënies.

Përgjegjësitë e Inspektoratit të Arsimit:

Inspektorati i Arsimit kryen detyrat e mëposhtme:

- siguron që vlerësimi i performancës së mësimdhënësve bëhet në përputhje me ligjin;
- mbledh të dhëna nga të gjithë komponentët e sistemit të vlerësimit të performancës;
- verifikon dhe monitoron saktësinë e aplikimeve të paraqitura nga kandidatët për procesin e PLA, duke siguruar që kandidatët aplikues kanë kaluar procedurat e vlerësimit të brendshëm për licencë të karrierës dhe i plotësojnë kushtet tjera për të aplikuar për të hyrë në procesin e PLA;
- planifikon aspektet teknike dhe profesionale të vlerësimit të jashtëm për licencë të avancuar;
- angazhon sipas nevojës ekspertë dhe vlerësues të jashtëm për të mbështetur procesin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve për licencë të avancuar;
- organizon seanca informimi dhe trajnime me ekipet e vlerësimit të mësimdhënësve për licencë të avancuar;
- realizon vlerësimin e jashtëm të mësimdhënësve për licencë të avancuar;
- përgatit raport për vlerësimet e jashtme për licencë të avancuar dhe e integron në bazën e të dhënave të sistemit të licencimit;
- rekomandon për revokim të licencës, përtëritje apo avancim të mësimdhënësit;
- bën rekomandimet e nevojshme për zhvillim profesional të vazhdueshëm të mësimdhënësve në përputhje me sistemin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve dhe kërkesat për licencë të avancuar;
- Përgatit raport vjetor për procesin e vlerësimit të jashtëm për licencë të avancuar.

Përgjegjësitë e DKA-së:

DKA në secilën komunë kryen detyrat e mëposhtme:

- Mbështet drejtorët e shkollave për përgatitjen e procesit të vlerësimit të brendshëm të performancës së mësimdhënësve, si hap i parë për të siguruar mundësi të mësimdhënësve për aplikim për provimin për licencë të avancuar;
- bën informim në nivel komune për pakon e vlerësimit për licencë të avancuar;
- informon kandidatët në nivel komune për procedurat dhe rregullat e procesit të aplikimit për PLA;
- kryen përgjegjësitë e përcaktuara për DKA në sistemin e licencimit - databazën e të dhënave sipas kërkesave të modulit për licencën e avancuar;
- menaxhon buxhetin e ndarë nga qeveria për licencimin e mësimdhënësve;
- siguron përfshirjen në listën e pagave të të gjithë mësimdhënësve që kanë marrë licencë të avancuar për mësimdhënie, sipas kodeve përkatëse;
- në bashkëpunim me ekipin komunal, analizon rezultatet e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve në nivel komune;
- harton planin komunal të zhvillimit profesional të mësimdhënësve bazuar në rekomandimet nga raportet për vlerësim të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së mësimdhënësve.

Përgjegjësitë e drejtorit të shkollës:

Drejtori/drejtoresha në secilën shkollë kryen detyrat e mëposhtme:

- Planifikon dhe realizon procesin e vlerësimit të brendshëm të performancës së mësimdhënësve, si hap i parë për të siguruar mundësi të mësimdhënësve për aplikim për provimin për licencë të avancuar;
- bën informim në nivel shkolle për pakon e vlerësimit për licencë të avancuar, procedurat dhe rregullat e procesit të aplikimit për PLA;
- kryen përgjegjësitë e përcaktuara për shkollën në sistemin e licencimit - databazën e të dhënave sipas kërkesave të modulit për licencën e avancuar;
- përkrahë mësimdhënësit dhe ofron rekomandime në hartimin e planit për përmirësim sipas rekomandimeve nga vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i performancës së mësimdhënësit;
- menaxhon buxhetin e ndarë nga qeveria për licencimin e mësimdhënësve;
- kryen të gjitha procedurat e përcaktuara për shkollën për përfshirjen në listën e pagave të të gjithë mësimdhënësve që kanë marrë licencë të avancuar për mësimdhënie;
- në bashkëpunim me ekipin me bazë në shkollë, analizon rezultatet e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve në nivel komune;
- përmirëson planin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë mbështetur në rezultatet e VPM dhe të vlerësimit të jashtëm për licencë të avancuar.

Përgjegjësitë e mësimeve:

Mësimeve kandidat për marrjen e licencës së avancuar kryen detyrat e mëposhtme:

- Ushtron profesionin e mësimeve sipas standardeve të performancës për mësimeve;
- Respekton të gjitha procedurat ligjore në fuqi për vlerësim të performancës së mësimeve, përfshirë ato që lidhen me provimin dhe vlerësimin e jashtëm për marrjen e licencës së avancuar;
- Përgatitë dosjen personale profesionale për të dëshmuar përfundimin e orëve të ZHPM (të paktën 200 për licencë të avancuar, prej tyre 50 % nga programet e avancuara dhe 50% nga aktivitetet e ZHPMBSH), si dhe ofron dëshmi për punën dhe arritjet personale profesionale nga data e marrjes së licencës aktuale të karrierës;
- Përgatitet dhe realizon orën/ët mësimore sipas kalendarit të përcaktuar nga IA
- Respekton të gjitha rregullat e përcaktuara për ditën e zhvillimit të provimit për marrjen e licencës së avancuar dhe të përgjegjësiave nga vlerësimi i jashtëm që kryhet nga IA, përfshirë rregullat e mëposhtme:
 - të jenë të pajisur me dokument identifikimi (letërnjoftim ose pasaportë);
 - të paraqiten së paku 30 minuta përpara fillimit të provimit;
 - të mos mbajnë dhe të mos përdorin telefonin celular dhe mjete të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo përbën kriter s kualifikimi;
 - të mos pinë duhan dhe të mos konsumojnë ushqime në mjediset e provimit;
 - të mos komunikojnë me njëri tjetrin gjatë zhvillimit të provimit; dhe
 - të gjitha rregullat tjera të cilat prezantohen në qendrën e provimit;
 - të gjitha rregullat e përcaktuara nga IA për vlerësim të jashtëm – vëzhgim të orës mësimore dhe prezantim të dosjes personale profesionale
- Në bashkëpunim me drejtorin e shkollës përpilon planin e përmirësimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional.

4. Përgatitja dhe organizimi i provimit për licencë të avancuar

MASHTI çdo vit organizon provimin e kualifikimit për licencë të avancuar. Provimi për licencë të avancuar organizohet në mbështetje të Udhëzimeve administrative (UA 14/2023 dhe UA 15/2023) dhe rregullimeve tjera ligjore që lidhen me procesin VPM për licencë të avancuar.

I gjithë procesi i provimit për licencë të avancuar organizohet duke marrë për bazë aspektet në vijim:

- Programet orientuese për organizimin e provimit për licencë të avancuar
- Testet e provimit për licencë të avancuar
- Administrimi i provimit për licencë të avancuar

- Mjediset e provimit për licencë të avancuar
- Rregullat e provimit për licencë të avancuar
- Vlerësimi i provimit për licencë të avancuar.

4.1. Programet orientuese për organizimin e provimit për licencë të avancuar

Programet orientuese për organizimin e provimit për licencë të avancuar hartohen nga MASHTI, ekipet profesionale të organizuara sipas fushave të programeve. Programet orientuese udhëheqin zhvillimin e mësimdhënësve për praktikën më efektive të mësimdhënies, për të arritur standarde të larta në punë dhe në sjellje që lidhen me pritshmëritë për mësimdhënës të avancuar, si dhe organizimin e provimit për licencë të avancuar.

Për të qenë në ndihmë të gjithë mësimdhënësve dhe akterëve tjerë të përfshirë në procesin e provimit për licencë të avancuar, programet orientuese publikohen në faqen zyrtare të MASHTI-it, ato përditësohen nga viti në vit sipas nevojave dhe praktikës së realizimit të provimit për licencë të avancuar.

Hartimi i programeve orientuese për organizimin e provimit për licencë të avancuar bazohet në të gjitha kurrikulat - programet mësimore për të cilat mësimdhënësit janë kualifikuar dhe japin mësim në periudhën e organizimit të provimit.

Mësimdhënësit e arsimit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë që japin më shumë se një lëndë, do t'i nënshtrohen procesit të provimit për licencë të avancuar për lëndën në të cilën zhvillojnë më shumë orë mësimore vjetore gjatë vitit kur organizohet provimi.

Për vitin 2024 janë zhvilluar tri programe orientuese të zhvillimit profesional të mësimdhënësve të miratuara nga MASHTI për mësimdhënës në sistemin e arsimit parauniversitar, për të cilat këtë vit organizohet provimi për licencë të avancuar:

- Programi i orientues për marrjen e licencës së avancuar për **Mësues të arsimit fillor**;
- Programi i orientues për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie – **Mësimdhënës të lëndës “Gjuhë shqipe”** të arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë; dhe
- Programi i orientues për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie – **Mësimdhënës të lëndës “Matematikë”** të arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë.

4.2. Testet e provimit për licencë të avancuar

Testet e provimit për licencë të avancuar janë specifike, sipas kualifikimit, fushës së programit universitar për të cilën mësimdhënësit janë të kualifikuar. Në baza vjetore, MASHTI do të organizojë provimin për licencë të avancuar dhe do të përgatisë teste sipas programeve. Për vitin 2024 janë përgatitur testet në vijim:

- Testi për mësues të arsimit fillor;
- Testi për lëndën e Gjuhës shqipe për AMU dhe AML; dhe
- Testi për lëndën e Matematikës për AMU dhe AML.

Testet hartohen nga grupe të ngritura nga MASHTI, të përbëra nga ekspertë të aspekteve të përgjithshme të provimit për licencë të avancuar dhe ekspertë që mbulojnë aspektet e programeve lëndore, aspektet e pedagogjisë, metodologjisë dhe përmbajtjet shkencore e lëndës për të cilën hartohen testet e provimit për licencë të avancuar.

Do të jetë një test i provimit për licencë të avancuar për një program (p.sh. Testi për mësues të arsimit fillor), i cili përbëhet nga dy pjesë:

- **Pjesa e parë** përmban dokumentet zyrtare që kanë të bëjnë me veprimtarinë e mësuesve, programet përkatëse lëndore, metodologjinë e mësimitdhënie - nxënies në përgjithësi dhe të lëndës përkatëse, gjithëpërfshirjen, etikën, sjelljen e mësimitdhënësit, si dhe aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- **Pjesa e dytë** përfshin përmbajtjen shkencore të lëndës sipas programit të provimit përkatës për licencë të avancuar.

Detajet e fushave të zhvillimit profesional për të cilat hartohen kërkesa/pyetje, % dhe numri i pikëve të testit për secilën fushë dhe pikë minimale pjesët e provimit, janë prezentuar në pjesën 3.1. të këtij udhëzuesi.

4.3. Administrimi i provimit për licencë të avancuar

Siç është përshkruar më sipër, formati i provimit do të jetë test me laps-letër dhe rezultatet përgatiten me lexues optik. Për procesin e administrimit të provimit, MASHTI kujdeset që të angazhoj administrues dhe përgjegjës të administrimit të provimit, të cilët përzgjidhen nga radhët e punonjësve arsimor të përcaktuar nga mekanizmat e MASHTI-t që kanë përgjegjësi për organizimin e këtij provimi.

Përgjegjësi i administrimit të provimit kujdeset që së bashku me administratorët tjerë të organizon proces të provimit korrekt dhe të krijoj kushte për punë të pavarur të gjithë kandidatëve, si dhe të veprojnë në bazë të rregullave specifike që përcaktohen nga MASHTI për administrimin e provimit për LA, përfshirë edhe raportin për mbarëvajtjen e këtij procesi në qendrën e provimit.

Në linjë të njëjtë vepron edhe secili administrator i provimit në sallën e testimit. Ai/ajo kujdeset që të ketë zhvillim korrekt të provimit, të pranojë dhe dorëzojë me kohë të gjitha materialet që lidhen me letër-testet e kandidatëve, të respektoj orarin e zhvillimit të provimit, të sigurojë punë të pavarur të gjithë kandidatëve, të respektoj të gjitha rregullat specifike të përcaktuara nga MASHTI për mbarëvajtjen e testimit në sallën përkatëse, si dhe hartoj dhe dorëzojë raportin apo procesverbalin për mbarëvajtjen e testimit në sallën ku ka administruar provimin.

4.4. Mjediset e provimit për licencë të avancuar

Provimi organizohet dhe administrohet në një vend dhe në kohën e njëjtë për të gjithë kandidatët. Për këtë kandidatët informohen paraprakisht. Për të siguruar mjedis mundësues të organizimit të provimit, përgjegjësit për organizimin e provimit duhet të kujdesen që në qendrën përkatëse të mos organizohet veprimtari tjetër deri në përmbylljen e procesit të provimit.

Gjithashtu, përgjegjësit për organizimin e provimit në qendrën/mjediset e përcaktuara për provim, duhet të kujdesen që të përmbushin të gjitha standardet e përcaktuara nga MASHTI për numrin e kandidatëve në një sallë, distancën në mes të kandidatëve, qëndrimin e personave të autorizuar, etj.

4.5. Rregullat e provimit për licencë të avancuar

Çdo provim, pra edhe provimi për licencë të avancuar ka rregullat e veta të cilat duhet ti respektojnë institucionet që kanë rol në organizimin e provimit, administruesit, kandidatët të cilët marrin pjesë në provim, por edhe personat tjerë të cilët kanë rol në ditën e organizimit të provimit.

Rregullat e para që duhet zbatuar lidhen me hartuesit e testeve për ruajtjen e fshehtësisë së testeve, vlerësuesit e testeve për të qenë korrekt dhe objektiv e të paanshëm gjatë vlerësimit të testeve, pastaj me mënyrën, sekretimit të testeve me anë të barkodeve të vendosura nga komisioni i caktuar nga MASHTI.

Rregullat për administruesit lidhen me zbatimin e udhëzimeve dhe rregullave të vendosura për procesin e organizimit të provimit për licencë të avancuar. Administruesit në sallën ku janë vendosur kandidatët për provim, në radhë të parë duhet tu ndalohet:

- të japë kopje ose të lejojë të kopjohet;
- të mbajë celular gjatë zhvillimit të provimit;
- të largohet nga mjedisi i provimit duke lënë kandidatët pa një zëvendësues;
- të komunikojë me kandidatin për përmbajtjen e testit;
- të shfletojë ose të bëjë shënime në materialet e provimit, si gjatë edhe pas përfundimit të provimit.

Ndërsa, lidhur me kandidatët janë disa rregulla bazike të cilat duhet të respektohen. Nëse ato nuk respektohen, kandidatët mund të s'kualifikohen ose ti humbë pikët nga provimi për licencë të avancuar. Kandidatit nuk duhet ti lejohej:

- të marrë ose të japë informacion ose kopje nga një kandidat tjetër;
- të komunikojë me një kandidat tjetër;
- të bëjë komente për përmbajtjen ose zgjidhjen e testit gjatë kohës së zhvillimit të provimit;
- të mbajë celular ose mjet tjetër të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit;
- të plotësojë testin me laps;
- të shkruajë në fletën e provimit ndonjë shënim tjetër përveç çfarë kërkon testi;
- të ketë me vete materiale të tjera, si: libra, fletore, fletë të bardha etj.;
- të ndërrojë vendin e paracaktuar;
- të mos dorëzojë testin tek administratori.

4.6. Vlerësimi i provimit për licencë të avancuar

Rezultatet e provimit për licencë të avancuar përgatiten me lexues optik, në mjediset e përcaktuara nga MASHTI, nga komisioni i vlerësimit të testeve. Rezultatet përgatiten në bazë të çelësit të kërkesave/pyetjeve të përgatitura nga hartuesit e testeve dhe në bazë, nga lista e kërkesave/pyetjeve të përzgjedhura prej bankës së pyetjeve për programin përkatës të vlerësimit (arsimit fillor, gjuhë shqipe, matematikë).

Pavarësisht faktit se rezultatet e provimit për licencë të avancuar përgatiten me lexues optik, MASHTI duhet të kujdeset që të themelojë komisionin për shqyrtimin e testeve të dyshuara për kopjim dhe shqyrtimin e ankesave të kandidatëve për vlerësimin e kryer. Komisioni duhet të shqyrtoj çdo rast të ngritur dhe duhet të nënshkruaj procesverbalin përkatës.

5. Përgatitjet dhe organizimi i vlerësimit të jashtëm të performancës së mësimitdhënësve për licencë të avancuar

Procesi i vlerësimit të jashtëm të performancës së mësimitdhënësve realizohet nga Inspektorati i Arsimit (IA). Vlerësimi nga IA, vlerësimi për licencë të avancuar realizohet pas përfundimit të provimit të kualifikimit për këtë licencë dhe përfshin vetëm mësimitdhënës të cilët kanë përfunduar me sukses provimin e kualifikimit.

Për këtë proces të vlerësimit, fillimisht IA shqyrton listën e mësimitdhënësve të cilët kanë përfunduar me sukses provimin kualifikues për licencë të avancuar, analizon fushat e kualifikimit të mësimitdhënësve dhe kapacitetet e inspektoratit për të mbuluar të gjithë mësimitdhënësit që duhet të vlerësohen, si dhe mundësitë e angazhimit të bashkëpunëtorëve/ekspertëve për këtë proces të vlerësimit. Mbi këtë analizë, IA harton planin e veprimtimit për VPM, të gjithë atyre që i plotësojnë kushtet për vlerësim të jashtëm për marrjen e licencës së avancuar për mësimitdhënie.

Në hapin e radhës, IA në koordinim me mësimitdhënësit që do të vlerësohen dhe me drejtorët e shkollave të tyre, i zhvillon të gjitha përgatitjet e duhura për të siguruar që vlerësimi realizohet me profesionalizëm, qasje gjithëpërfshirëse dhe me efektivitet të lartë. Përgatitjet dhe organizimi për këtë proces përfshijnë disa nga veprimet në vijim:

- Inspektori i arsimit e informon drejtorin e shkollës për planin dinamik orientues për VPM- së të mësimitdhënësit/ve të shkollës që do të përfshin në vlerësimin e organizuar nga IA për licencë të avancuar;
- Inspektori i arsimit e kontakton mësimitdhënësin për ta diskutuar të gjithë procesin dhe për t'i siguruar të gjitha dokumentet relevante dhe formularët e vlerësimit për Protokollin e vëzhgimit në klasë dhe portfolion profesionale me Planifikimin dhe përgatitjen me shkrim të njësisë mësimore;
- Inspektori i arsimit dhe mësimitdhënësi bien dakord për afatin kohor për përfundimin e portfolios profesionale - dokumenteve për Planifikimin dhe përgatitjen me shkrim të njësisë mësimore dhe për vlerësimin e njësisë mësimore.

Siç kemi përshkruar në pjesën e dytë të këtij udhëzuesi, vlerësimi nga Inspektorati i Arsimit (IA) për licencë të avancuar përfshin vlerësimin e portfolios profesionale dhe vlerësimin e njësisë apo orës mësimore. Për të dy këto komponente të vlerësimit nevojiten përgatitje të duhura, prandaj në pjesën vijuese do të ofrohen udhëzime që ndihmojnë mësimdhënësit kandidatë për licencë të avancuar dhe vlerësuesit nga Inspektorati i Arsimit.

Udhëzime për komponentin e përgatitjes së portfolios profesionale me planifikime dhe përgatitje me shkrim

Komponenti i Planifikimit dhe përgatitjes me shkrim të VPM-së është një grup i tre deri pesë mësimëve të njëpasnjëshme, që synon të zhvillojë një koncept të veçantë ose koncepte të lidhura. Qëllimi i Planifikimit dhe përgatitjes me shkrim është të paraqesë kontekstin e mësimit që do të vëzhgojë Inspektori Pedagogjik. Në këtë komponent, do t'ju kërkohet të paraqitni tri plane të hollësishme të mësimit: një për mësimin që paraqitet një ditë para vëzhgimit tuaj të planifikuar, një për ditën e vëzhgimit tuaj dhe një për ditën pas vëzhgimit. Do t'ju parashtrihen disa pyetje në lidhje me konceptet që po jepni mësim dhe si po zhvilloni dhe vlerësoni të kuptuarit që nxënësit tuaj kanë për këto koncepte. Dorëzimi nga ju i Planifikimit dhe përgatitjes me shkrim do të ketë tri produkte të përshkruara më poshtë.

Struktura e Planifikimit dhe përgatitjes me shkrim

Planifikimi dhe përgatitja me shkrim për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve kërkon nga kandidati dorëzimin e një përmbledhje të dëshmimeve dhe rezultateve nga praktika e mësimdhënies, të strukturuar në tri produkte.

	Produktet e kërkuara	Pikët e vlerësimit sipas produkteve
Planifikimi dhe përgatitja me shkrim	Produkti 1 Planet e detajuara të tri deri pesë njësive mësimore	1 pikë
	Produkti 2 Vlerësimi i të kuptuarit të nxënësve	3 pikë
	Produkti 3 Reflektim rreth praktikës suaj të mësimdhënies	3 pikë
Gjithsej pikë		12.5 pikë

Produkti 1: *Planet e detajuara të tri deri pesë njësive mësimore të njëpasnjëshme në kuadër të një teme mësimore.* Ky produkt kërkon një përshkrim të hollësishëm të një sekuence prej tri deri shtatë njësive mësimore të njëpasnjëshme që synojnë të zhvillojnë një koncept nga Kurrikula Bërthamë apo një temë mësimore nga plani dhe programi lëndor që ju planifikoni ta realizoni gjatë vlerësimit nga Inspektori.

Produkti 2: *Vlerësimi i të kuptuarit të nxënësve.* Ky produkt kërkon të bashkëngjitni një instrument që do të përdoret për të vlerësuar të kuptuarit e nxënësve për konceptet e mësuara në produktin 1. Ju gjithashtu do të bashkëngjitni punën aktuale të nxënësve që e dëshmon të nxënësit gjatë këtyre njësive mësimore.

Produkti 3: *Reflektim rreth mësimdhënies suaj.* Ky produkt ju kërkon të reflektoni në mënyrë kritike për suksesin e mësimdhënies tuaj në tri deri shtatë mësimet, duke përfshirë atë që ka shkuar mirë dhe çfarë do të duhej të ndryshohej në mënyrë që të rritet të nxënësit e nxënësve.

Lidhja e produkteve të planifikimit dhe përgatitjes me shkrim me standardet për mësimdhënës

Secili produkt i planifikimit dhe përgatitjes me shkrim është dizajnuar të përafrohet me standardet për mësimdhënës dhe treguesit specifikë të përcaktuar në dokumentin *Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë*. dhe Është e rëndësishme të kuptohet kjo ndërlidhje për faktin se secili produkt do të vlerësohet sipas standardeve të përshkruara në pjesën vijuese.

Produkti 1 - Planet e detajuara për tri deri pesë njësi mësimore të njëpasnjëshme që japin mësim një koncept të unifikuar ose një sërë konceptesh - përputhet me:

- Standardin 12.1 Kupton zhvillimin fizik, social dhe intelektual të nxënësve dhe promovon të nxënësit gjatë gjithë jetës.
- Standardin 13.1 Njeh përmbajtjen e fushës së mësimdhënies në Kurrikulën Bërthamë.
- Standardin 14.2 Përdor një shumëllojshmëri të strategjive të mësimdhënies për t'i motivuar nxënësit dhe nxitur nivel më të lartë të të menduarit.
- Standardin 14.3 Përzgjedh dhe përdor burimet e duhura dhe zhvillon materiale mësimore për temat për të cilat nuk ka literaturë.
- Standardin 14.4 Përdorimi i teknologjisë adekuate në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme.
- Standardin 15.1 Kryen vlerësimin e vazhdueshëm të progresit të nxënësve, siguron informacion mbi baza të vazhdueshme dhe planifikon mbështetje shtesë për të përmirësuar arritjet e nxënësve.

Produkti 2 - Vlerësimi i të kuptuarit të nxënësve - përputhet me:

- Standardin 15.1 Kryen vlerësimin e vazhdueshëm të progresit të nxënësve, siguron informacion mbi baza të vazhdueshme dhe planifikon mbështetje shtesë për të përmirësuar arritjet e nxënësve.

Produkti 3 - Reflektimi rreth praktikës së mësimdhënies - përputhet me:

- Standardin 16.4 Përshtat dhe përmirëson praktikatat e mësimdhënies përmes të nxënësit dhe reflektimit

Procedura për planifikim dhe përgatitje me shkrim

Planifikimi dhe përgatitja me shkrim është komponent i vlerësimit të jashtëm të VPM. Procesi i Vlerësimit të Jashtëm të VPM-së paraqitet më poshtë:

- Inspektori kontakton mësimdhënësin për të diskutuar të gjithë procesin për të siguruar të gjitha dokumentet relevante, formularët e vlerësimit për Vëzhgim në Klasë dhe Planifikimin dhe përgatitjen me shkrim.
- Inspektori dhe mësimdhënësi bien dakord për afatin kohor për përfundimin e dokumenteve për Planifikim dhe përgatitje me shkrim.
- Mësimdhënësi do të punojë në hartimin e një drafti të përafërt për Planifikim dhe përgatitje me shkrim.
- Takimi për Vëzhgimin në Klasë do të realizohet kur mësimdhënësi të ketë përfunduar draftin e Planifikimit dhe përgatitjes me shkrim dhe së bashku me Inspektorin do të bien dakord se cila prej

njësive mësimore do të vëzhgohet. Njësia mësimore për vëzhgim mund të ndryshohet vetëm në marrëveshje paraprake me Inspektorin.

- Mësimdhënësi do të plotësojë në detaje Planifikimin dhe përgatitjen me shkrim, duke plotësuar të gjitha informacionet në formularët përkatës për produktin 1.
- Mësimdhënësi do të realizojë njësitë tjera mësimore siç janë planifikuar dhe mban shënime të detajuara për të gjitha njësitë mësimore, detyrat dhe vlerësimet.
- Inspektori do të vijë të vëzhgojë orën e caktuar mësimore, sipas *Protokollit të Vëzhgimit në Klasë (PVK), formulari në shtojcë.*
- Pas realizimit të njësive mësimore të planifikuara, mësimdhënësi plotëson formularët për Produktet 2 dhe 3:
 - Analiza e vlerësimit të bërë së bashku me tre shembuj të punës praktike të nxënësve siç është përshkruar në Produktin 2.
 - Reflektimi për zbatimin e njësive mësimore, siç përshkruhet në Produktin 3.
- Të gjithë formularët e plotësuar dhe dokumentet/dëshmitë përcjellëse i dërgohen inspektorit brenda një jave pas realizimit të njësive mësimore.
- Inspektori i shqyrton formularët dhe i vlerëson me pikë sipas rubrikës dhe përgjigjeve të dhëna.
- Inspektori informon mësimdhënësin dhe drejtorin e shkollës në lidhje me rezultatet e vlerësimit brenda një jave.
- Nëse mësimdhënësi merr një rezultat prej të paktën 24 pikësh nga vlerësimi i jashtëm i drejtuar nga IA, merr licencë të avancuar për mësimdhënie.
- Vendimi i Inspektorit bazuar në raportin dhe rezultatin përfundimtar të vlerësimit të jashtëm së bashku me rezultatet e provimit të kualifikimit për licencë të avancuar dorëzohen në MASHTI dhe regjistrohet në databazën e licencimit.

Mësimdhënësi i pakënaqur me vlerësimin e jashtëm të drejtuar nga Inspektorati i Arsimit mund ta apelojë vendimin tek Paneli i Artë. Vendimi i Panelit të Artë është përfundimtar.

Udhëzime dhe orientime shtesë lidhur me kërkesat për Planifikim dhe përgatitje me shkrim

Dorëzimi përfundimtar nga mësimdhënësi i Planifikimit dhe përgatitjes me shkrim do të bëhet pasi të jenë dhënë të gjitha mësimet dhe mësimdhënësi të jetë vëzhguar nga Inspektori. Nëse dorëzimi nuk është i plotë në çfarëdo mënyre mënyrë, Inspektori mund t'jua kthejë *një herë* që ta plotësoni. Nëse sërish merret në një gjendje jo të plotë, do të konsiderohet i dorëzuar.

Për të garantuar rezultatin e duhur të Planifikimit dhe përgatitjes me shkrim, çdo produkt i paraqitur duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- Të gjitha produktet duhet t'i referohen klasës së njëjtë të nxënësve.
- Ju duhet të zhvilloni Planifikimin dhe përgatitjen me shkrim rreth një fushe të përmbajtjes. Pra, nëse jepni mësim më shumë se një lëndë, atëherë ju duhet të zgjidhni lëndën me më shumë orë mësimore gjatë javës.
- Ju lutemi ndiqni strukturën dhe sekuencën në të cilën kërkohet informacioni.
- Zhvilloni të gjitha produktet duke përdorur fletët e ofruara të përgjigjeve. Plotësojini në kompjuter dhe printoni.

- Plotësoni fletët e përgjigjeve duke përdorur rreshta me hapësirë 1 dhe në format të letrës A4. Mund t'ju duhet të përdorni më shumë se një faqe për të përshkruar aktivitetet tuaja të nxënësve. Ju lutemi të siguroni maksimumi dy faqe për çdo mësim.
- Shkruani emrin dhe ID-në tuaj në çdo fletë përgjigjesh që dërgoni.
- Dërgoni vetëm informacionin e kërkuar. Çdo informacion shtesë që dërgoni nuk do të merret në konsideratë gjatë vlerësimit. Dokumentet që dërgoni nuk do t'ju kthehen. Prandaj, sigurohuni që të mbani kopjet e të gjitha materialeve të paraqitura.
- Para se t'i dorëzoni, verifikoni se keni zhvilluar dhe përfshirë çdo produkt të kërkuar.

Produkti 1: Tri deri pesë plane të detajuara mësimore të njëpasnjëshme

Ky produkt synon të vlerësojë aftësinë tuaj për të planifikuar dhe zbatuar tri deri pesë njësi mësimore që trajtojnë karakteristikat dhe nevojat e nxënësve në një klasë, demonstron një sekuencë koherente të të nxënësve, përdor materiale të përshtatshme në përputhje me qëllimet e të nxënësve dhe vlerëson në mënyrë adekuate të nxënësve e nxënësve.

Produkti i planifikimeve të njësisve mësimore duhet të reflektojë standardet themelore për mësimdhënës të përshkruara më sipër.

Si të veproni në përgatitjen e planifikimeve të lidhura me kërkesat e Produktit 1?

1. Përzgjidhni një ose më shumë rezultate të të nxënësve të lidhura me kompetencat e përcaktuara me Kurrikulën Bërthamë.
2. Përcaktoni një ose më shumë koncepte specifike dhe rezultate të të nxënësve që përputhen me rezultatin e të nxënësve që zgjidhni në hapin e mëparshëm në fushën tuaj të kurrikulës.
3. Tregoni të nxënësve paraprak relevant të nxënësve, që do t'u mundësojë të kuptojnë dhe të mësojnë konceptet e reja që planifikoni të jepni mësim.
4. Bazuar në këto koncepte dhe rezultate të nxënësve, planifikoni 3 deri 5 njësi mësimore të njëpasnjëshme për të adresuar këto rezultate. Zhvilloni një **skemë** të detajuar të planeve tuaja dhe dorëzoni tek Inspektori. Ai ose ajo do të organizojë një takim për të vëzhguar një nga këto mësimore për të përmbushur komponentin e Protokollit të Vëzhgimit në Klasë të VPM-së.
5. Përfshini në planin tuaj të gjitha procedurat e vlerësimit që do të përdorni për të përcaktuar suksesin e të nxënësve të nxënësve. Do t'ju kërkohet që të paraqisni në detaje një prej tyre në Produktin 2, pasi të jenë realizuar njësitë mësimore dhe të jenë vlerësuar nxënësit.

** Shënim: Vlerësimi mund të bëhet pasi të jenë realizuar më shumë se tri orë mësimore, pasi që zhvillimi i disa koncepte kërkon më shumë kohë. Megjithatë, vlerësimi juaj mund të bëhet në vazhdimësi sa herë që është e nevojshme të vlerësonit nxënësit gjatë këtyre orëve mësimore.*

6. Pasi të jenë realizuar njësitë mësimore, dhe një orë të jetë vëzhguar nga Inspektori, ju do të plotësoni dhe dorëzoni të gjithë informacionin e kërkuar për orët e mbajtura mësimore.

Produkti 1: Njësia mësimore 1

Emri		Rajoni	
Shkolla		Klasa	
Data e mbajtjes:		Fusha e kurrikulës	
Rezultatet e të nxënimit: (Këto duhet të merren nga kurrikula bërthamë)			

P.sh.

Komunikimi dhe të shprehurit: Lexon një tekst të palexuar më parë.

ose

Kompetenca e të menduarit: Identifikon tiparet e përbashkëta të gjërave të gjalla

Konceptet, aftësitë dhe kuptimet që nxënësit do të fitojnë nga njësia mësimore

Shkruani **një ose më shumë** rezultate **specifike të** të nxënimit të synuara nga njësia mësimore, duke përfshirë konceptet, shkathhtësitë dhe aftësitë që nxënësit do të fitojnë si rezultat i mësimit. Tregoni si do të kontribuojnë aktivitetet në të nxënimit e tyre. Këto duhet të dalin direkt nga plani dhe programi për lëndën përkatëse. Për shembull:

Gjuha dhe komunikimi - Interpreton tekste letrare

OSE

*Matematika - Kryen operacione themelore matematikore me numra deri në shtatë shifra dhe kupton numrat e plotë dhe thyesat negative **DHE** zhvillon, zgjedh dhe zbaton strategjitë e zgjidhjes së problemeve.*

Të nxënimit paraprak relevant

Cilat njohuri apo shkathhtësi paraprake të nxënësve do t'i ndihmojnë ta kuptojnë më mirë këtë njësi mësimore?

Përshkrimi i aktiviteteve dhe burimeve të të nxënimit

- 1.Listoni dhe përshkruani secilin nga aktivitetet e zbatuara gjatë gjithë mësimit.*
- 2.Identifikoni aktivitetet e vlerësimit (nëse ka).*
- 3.Në përshkrimin tuaj, përfshini përmbajtjet, shkathhtësitë dhe aftësitë që zhvillohen në çdo aktivitet, burimet e përdorura të të nxënimit, dhe mënyrën si e keni monitoruar punën e nxënësve.*

Shënim: Kjo faqe duhet të përdoret tri deri pesë herë, varësisht nga numri i njësive mësimore të planifikuara, në mënyrë që të ketë së paku nga një fletë për secilën njësi mësimore.

Produkti 2: Vlerësimi i të kuptuarit të nxënësve

Vlerësimet janë thelbi i çdo njësie të të nxënësve, sepse ato japin informacion të rëndësishëm për mësimdhënësin. Nëpërmjet metodave të ndryshme të vlerësimit, mësimdhënësi e njeh nivelin e arritjeve të secilit nxënës dhe cilat praktika mësimdhënëse duhet të forcohen ose modifikohen që të sigurohen arritjet. Vlerësimi siguron një kontribut thelbësor për hartimin e njësive mësimore të ardhshme. Për shkak të rëndësisë së këtij procesi, është gjithashtu e rëndësishme të pasqyrohet çka dhe si të vlerësohet.

Ky produkt do të demonstrojë aftësinë tuaj për të hartuar procedura të ndryshme vlerësimi të përshtatshme për nxënësit tuaj në përputhje me qëllimet tuaja të të nxënësve. Gjithashtu, do të demonstrojë aftësinë tuaj për të hartuar udhëzime të notimit duke përcaktuar qartë përgjigjet ose performancën që do të konsiderohen si të sakta.

Për përgatitjen e produktit 2, referojuni si po e përbushni Standardin 5.1: *Kryen vlerësimin e vazhdueshëm të progresit të nxënësve, siguron informacion mbi baza të vazhdueshme dhe planifikon mbështetje shtesë për të përmirësuar arritjet e nxënësve.*

Udhëzime për zhvillimin e Produktit 2

Produkti 2 ka tri pjesë. Ju lutemi sigurohuni që të përfshini të tri pjesët kur përgatitni fletët tuaja të përgjigjeve. Plotësoni të gjithë informacionin e kërkuar në fletët e përgjigjeve.

1. Në fletët e dhëna, përshkruani të gjitha procedurat e zbatuara të vlerësimit në të gjithë njësinë që përmban tri deri pesë mësimet që po dorëzoni.
2. Zgjidhni një nga procedurat e vlerësimit që keni administruar në këtë njësi. (Shihni 'a' më poshtë). Kjo procedurë e vlerësimit duhet të ketë përfshirë të gjithë nxënësit e klasës suaj.
3. Përfshini udhëzimet e vlerësimit që keni përdorur për këtë vlerësim. (Shihni 'b' më poshtë).
4. Siguroni kopjet e përgjigjeve të nxënësve siç përshkruhet në 'c' më poshtë.

Tri pjesët e Produktit 2

a) **Vlerësimet** - Ju lutemi lexoni të gjitha udhëzimet e mëposhtme dhe zgjidhni ato që korrespondojnë me procedurën e vlerësimit ose instrumentin që keni zgjedhur.

1. Nëse keni përdorur një test me shkrim ose një detyrë me shkrim, dorëzoni një kopje të instrumentit të vlerësimit, pikërisht ashtu siç u është dhënë nxënësve.
2. Nëse vlerësoni ndonjë performancë, prezantim ose produkt, për shembull performancë muzikore ose artistike, prezentim me gojë, debat, raport, ese ose projekt, shkruani një përshkrim të hollësishëm të vlerësimit të detyrës.

* Shënim: përfshini të gjitha udhëzimet që u jepen nxënësve, qoftë me shkrim apo me gojë.

b) **Udhëzues për vlerësim**

Paraqitni një kopje të udhëzimeve të vlerësimit që keni përdorur për të shënuar performancën e nxënësve tuaj.

1. Nëse keni përdorur një test me shkrim ose një detyrë me shkrim, dërgoni një kopje me përgjigjet e sakta:
 - Për pyetjet me zgjedhje të shumëfishta, shënoni opsionin e saktë.
 - Për pyetjet e hapura, tregoni idetë ose konceptet kryesore që keni konsideruar për t'i shënuar ato si përgjigje të sakta.
2. Nëse vlerësoni ndonjë performancë, ekzekutim apo produkt, për shembull performancë muzikore ose artistike, prezentim me gojë, debat, raport, ese ose projekt, ndër të tjera:
 - Paraqitni udhëzimet e vlerësimit, rubrikën ose listën e kontrollit që keni përdorur për të vlerësuar performancën e nxënësve. Ky udhëzues ose listë kontrolli duhet të përfshijë të gjitha aspektet ose kriteret e vlerësuar. Përfshini një përshkrim të performancës së pritshme ose performancës së konsideruar si të saktë.

c) **Përgjigjet ose produktet e nxënësve**

Përfshini në pakon tuaj:

1. përgjigjen e një nxënësi që tregoi se e ka kuptuar mirë konceptin që keni dhënë në mësim.
2. përgjigjen ose produktin e një nxënësi që tregoi të kuptuar të pjesshëm të konceptit.
3. përgjigjen e një nxënësi që nuk i plotësoi pritjet e vlerësimit.

Në rastin e performancës, përfshini nga një përshkrim të performancave të nxënësve që i përshtaten *secilës* nga tri kategoritë e mësipërme.

Nëse nuk ka nxënës në ndonjë nga këto kategori, ju lutemi shpjegoni pse mendoni se ka ndodhur kjo gjë.

Produkti 2: Vlerësimi i të kuptuarit të nxënësve

Emri:	Data e Vlerësimit:
Lloji i Vlerësimit	<i>Tregoni nëse vlerësimi është i vazhdueshëm apo përfundimtar, nëse ishte detyrë individuale ose grupore, dhe nëse ishte me shkrim, prezentim me gojë apo projekt.</i>
Qëllimi ose synimet e vlerësimit:	<i>Shkruani qëllimin ose qëllimet që synohet të vlerësohen nga instrumenti ose aktiviteti i vlerësimit. Çka pritej t'ju tregonte për të nxënësit e nxënësve?</i>

Formati i vlerësimit: *Ju lutemi bashkëngjitni një kopje të detyrës ose përshkruajeni në detaje, duke përfshirë të gjitha udhëzimet që u jepen nxënësve.*

Udhëzuesi i notimit: *Ju lutemi bashkëngjitni ose shkruani në hapësirën poshtë fletës së përgjigjeve, rubrikën ose grupin e udhëzimeve për të përcaktuar si e ka demonstruar nxënësi të nxënësit.*

Shembuj të përgjigjeve të nxënësve: *Bashkëngjisni së paku 3 përgjigje të nxënësve për vlerësimin ose detyrën. Përfshini:*

- 1. përgjigjen e një nxënësi që tregoi se e ka kuptuar mirë konceptit që keni dhënë në mësim.*
- 2. përgjigjen ose produktin e një nxënësi që tregoi të kuptuar të pjesshëm të konceptit.*
- 3. përgjigjen e një nxënësi që nuk i plotësoi pritjet e vlerësimit.*

** Sigurohuni që të identifikoni cili nga shembujt e mësipërm ilustron secilin nga punimet e nxënësve.*

Produkti 3: Reflektim rreth praktikës suaj të mësimdhënies

Kapaciteti i mësimdhënësve për të reflektuar në mënyrë kritike për praktikën e tyre është i nevojshëm për ngritjen e tyre profesionale. Kjo aftësi u lejon mësimdhënësve të marrin vendime adekuate pedagogjike, të parashikojnë vështirësitë, të përcaktojnë aspektet e performancës së tyre dhe të përmirësojnë performancën e nxënësve të tyre, të hartojnë aktivitete korrigjuese të përshtatshme etj. Reflektimi u mundëson mësimdhënësve të përfitojnë nga përvoja e tyre dhe të mësojnë nga vendimet e tyre të suksesshme si dhe nga gabimet e tyre.

Ky produkt është një ftesë për mësimdhënësin që të reflektojë mbi zbatimin e planeve mësimore. Reflektimi do t'ju mundësojë vlerësuesit të vlerësojë aftësinë e mësimdhënësit për të vëzhguar dhe analizuar në mënyrë kritike praktikën e vet, si dhe për të propozuar veprime në të ardhmen, me qëllim të promovimit të arritjeve arsimore të nxënësve të vet.

Treguesit themelorë të kornizës strategjike për Produktin 3

Reflektimi mbi praktikën e mësimdhënies është një pjesë kyçe e rritjes dhe zhvillimit profesional. Prandaj, ky komponent është i përvijuar sipas të gjithë treguesve të **Standardit 6: Angazhohet në zhvillim të vazhdueshëm profesional**

6.1 Identifikon dhe planifikon nevojat e të nxënit profesional

6.2 Përdor mësimet e reja profesionale për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies

6.3 Angazhohet me kolegë për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies.

*Shënim: Produkti 3 është më i lidhur me **Standardin dhe Treguesin 6.4:***

6.4 Përshtat dhe përmirëson praktikatat e mësimdhënies përmes të nxënit dhe reflektimit.

Udhëzime për zhvillimin e Produktit 3

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme duke përdorur maksimumi 5 faqe të shtypura ose të printuara vetëm në njërën anë dhe bashkëngjitni ato fletë.

1. Shqyrtoni praktikën tuaj të mësimdhënies siç tregohet në tri deri pesë njësi mësimore:

- a. Përmendni një aspekt të **performancës suaj të përgjithshme të mësimdhënies** që mendoni se është pika juaj më e fortë. Si mendoni se kontribuon në të nxënit e nxënësve tuaj?
- b. Përmendni një ose më shumë aspekte të performancës suaj të mësimdhënies që mund të përmirësohen. *Zgjidhni një aspekt të performancës suaj dhe jo ndonjë vështirësi të paraqitur nga nxënësit tuaj.*
- c. Përmendni një ose më shumë veprime konkrete që mund të zbatoni gjatë këtij viti për ta përmirësuar këtë aspekt. Tregoni vetëm veprimet e realizueshme: burimet dhe koha e kërkuar për veprimet korrigjuese duhet të jenë brenda mundësive tuaja.
 - Përshkruani veprimin që propozoni të ndërmerri.
 - Si do të kontribuonte në përmirësimin e mësimdhënies suaj?
 - Cilat burime janë të nevojshme?

2. Analiza e procedurës së vlerësimit

Konsideroni vlerësimin që keni paraqitur në Produktin 2.

Duke iu referuar drejtpërdrejt shembujve të punës së nxënësve që keni dorëzuar:

- a. Përmendni synimet e të nxënit të arritura nga nxënësit tuaj.
- b. Përmendni synimet e arritura pak ose aspak nga nxënësit tuaj.
- c. Bazuar në rezultatet e arritjeve të nxënësve, përshkruani një strategji të mësimdhënies që keni përdorur dhe që ka funksionuar mirë. Shpjegoni pse mendoni se ka funksionuar.

- d. Bazuar në rezultatet e arritjeve të nxënësve, si mund ta përshtatni mësimdhënien tuaj për të përmirësuar të nxënësit e nxënësve? Si mendoni se do të ndihmonte kjo?

3. Analiza kritike e orës së vëzhguar mësimore – ushtrimi reflektues

Analiza kritike e një ore mësimore është një ushtrim reflektues shumë i dobishëm. Konsideroni mësimin që u vëzhgua nga Inspektori. Duke përdorur 7 Dimensionet e Protokollit të Vëzhgimit në Klasë, plotësoni tabelën e mëposhtme dhe përgjigjuni pyetjeve që pasojnë, për të justifikuar notat që keni caktuar.

- a. Si do t'i vlerësonit mësimet e vëzhguara? Përdorni tabelën e mëposhtme dhe rrethoni numrin e duhur për secilin Dimension (numrat në kuti korrespondojnë me pikët që do të merrni në bazë të vëzhgimit në klasë nga Inspektori):

DIMENSIONI	I pakënaqshëm	I kënaqshëm	Mirë	Shkëlqyeshëm
1. Mjedisi pozitiv në klasë	0.5	1	2	2.5
2. Menaxhimi i kohës	0.5	1	2	2.5
3. Angazhimi i të gjithë nxënësve në aktivitetet e të nxënësit	0.5	1	2	2.5
4. Strukturimi i situatave të mirëfillta të të nxënësit	0.5	1	2	2.5
5. Zhvillimi i të kuptuarit të nxënësve	0.5	1	2	2.5
6. Vlerësimi i të kuptuarit të nxënësve	0.5	1	2	2.5
7. Zhvillimi i autonomisë	0.5	1	2	2.5

Duke përdorur përshkrimet për secilin Dimension, arsyetoni përgjigjet tuaja në pyetjet e mëposhtme:

- a. Cilat ishin aspektet më të mira të strategjive tuaja të mësimdhënies në këtë mësim? Çfarë dëshmie nga mësimi ju shtyn ta bëni këtë pohim?
- b. Cilat strategji shtesë ose alternative mund të përmirësojë të nxënësit e nxënësve?

Shtojca të instrumenteve që përdoren nga Inspektorati i Arsimit

Shtojca A: Formati dhe kriteret për vlerësimin e portofolit – produkteve, planifikimit dhe përgatitjes me shkrim

a	<p>Produkti 1: Planifikimi i njësive mësimore:</p> <p>Lidhja e rezultateve të nxënit të Kurrikulës Bërthamë me temën/njësitet mësimore (1 pikë)</p> <p>Përcaktimi i rezultateve të nxënit sipas përmbajtjes së temës/temave mësimore (1 pikë)</p> <p>Përshkrimi i të nxënit paraprak relevant (1 pikë)</p> <p>Përshkrimi i veprimtarive/aktiviteteve për realizimin e njësisë/ve mësimore – përputhshmëria me rezultatet e të nxënit. (1.5 pikë)</p> <p>Përcaktimi dhe përshkrimi i burimeve të përdorura për realizimin e njësisë/ve mësimore (1 pikë)</p> <p>Përshkrimi i monitorimit të punës së nxënësve gjatë realizimit të njësisë/ve (1 pikë)</p>	0-6.5 pikë
b	<p>Produkti 2: Vlerësimi i të kuptuarit të nxënësve</p> <p>Përdorimi i instrumentit të vlerësimit - testi me shkrim, detyra me shkrim ose forma tjetër e dorëzuar për vlerësim të nxënësve (1 pikë)</p> <p>Udhëzimet për vlerësim (1 pikë)</p> <p>Përgjigjet ose produktet e nxënësve (1 pikë)</p>	0-3 pikë
c	<p>Produkti 3: Reflektim rreth praktikës suaj të mësimdhënies</p> <p>Analiza e shqyrtimit të praktikës personale të mësimdhënies (1 pikë)</p> <p>Analiza e procedurës së vlerësimit nga produkti 2 (1 pikë)</p> <p>Analiza kritike e orës së vëzhguar mësimore – ushtrimi reflektues (1 pikë)</p>	0-3 pikë

Vlerësuesi i portfolios

Data

Shtojca B - Protokoli i Vëzhgimit në Klasë (PVK)

Protokoli i Vëzhgimit në Klasë (PVK)

Dimensioni 1: Klima pozitive në klasë

Dimensioni 2: Menaxhimi i kohës

Dimensioni 3: Angazhimi i nxënësve në aktivitetet mësimore

Dimensioni 4: Strukturimi i situatave mësimore kuptimplota

Dimensioni 5: Zhvillimi i të kuptuarit të nxënësve

Dimensioni 6: Vlerësimi i kuptimit të nxënësve

Dimensioni 7: Zhvillimi i autonomisë

Të dhënat rreth mësimitdhënës:

Numri i licencës së mësimitdhënësit _____

--	--

Emri

Mbiemri

--	--

Klasa

Lënda

Përvoja në mësimitdhënie (vitet dhe muajt):

--	--

Vite

Muaj

Të dhënat rreth shkollës:

--	--

Rajoni

Komuna

--

Emri i shkollës, vendi, adresa dhe kontakti (nr. telefoni apo email)

Dimensioni 1: Klima pozitive në dhomën mësimore

Pakënaqshëm	Kënaqshëm	Mirë	Shkëlqyeshëm
<p>Asnjë kusht i “Kënaqshëm” nuk është plotësuar.</p> <p>OSE</p> <p>Çrregullimet dominojnë mësimin pasi mësimdhënësi e menaxhon situatën në mënyrë joefektive ose efektet e veprimeve të tij janë shumë të shkurtra.</p> <p>OSE</p> <p>Mësimdhënësi ndërmerri masa të papërshtatshme për ta mbajtur disiplinën në dhomën mësimore.</p> <p>OSE</p> <p>Mësimdhënësi lejon sarkazëm ose fjalë të papërshtatshme mes nxënësve ose sillet në këtë mënyrë me ta.</p>	<p>Gjatë pjesës më të madhe të mësimit është e mundshme që të vëzhgojmë:</p> <p>Përmbushja e normave të sjelljes ashtu që mësimi të rrjedhë pa probleme.</p> <p>Mësimdhënësi dhe nxënësit tregojnë respekt për njëri-tjetrin.</p>	<p>Gjatë tërë mësimit është e mundshme që të vëzhgojmë:</p> <p>Përmbushja e normave të sjelljes ashtu që mësimi të rrjedhë pa probleme.</p> <p>Mësimdhënësi dhe nxënësit tregojnë respekt për njëri-tjetrin.</p> <p>Nxënësit tregojnë respekt për njëri-tjetrin.</p> <p>Nxënësit ndajnë ide dhe punojnë së bashku për të gjetur zgjidhje.</p>	<p>Të gjitha kushtet e “Mirë” janë përmbushur</p> <p>DHE</p> <p>Mësimdhënësi nuk e humb pasqyrën e klasës dhe vepron në mënyrë preventive për t’i shmangur çrregullimet</p> <p>OSE</p> <p>Mësimdhënësi jep reagime pozitive për nxënësit në lidhje me përmbushjen e normës së sjelljes</p> <p>OSE</p> <p>Promovon reflektim në çdo normë të sjelljes</p> <p>OSE</p> <p>Në mënyrë eksplicite përmend pse është e rëndësishme që të përmbushen normat në mënyrë që të mësohen.</p>

(Shëno kutinë e duhur):

Jo e dukshme	Kënaqshëm	E mirë	E shkëlqyeshme
1	4	5	6

Dëshmi për pikët:

Dimensioni 2: Menaxhimi i kohës

Pakënaqshëm	Kënaqshëm	Mirë	Shkëlqyeshëm
<p>Asnjë kusht i “Kënaqshëm” nuk është plotësuar.</p> <p>OSE</p> <p>Disa nxënës nuk po bëjnë asnjë mësim (pasi që e përfunduan aktivitetin shumë shpejt ose nuk kishin qasje në materialet mësimore).</p> <p>Disa nxënës nuk kanë kohë të mjaftueshme për ta përfunduar aktivitetin.</p> <p>Mësimdhënësi shpenzon shumë kohë duke dhënë udhëzime, duke filluar një aktivitet të ri, ose në veprime të tepërta ose të panevojshme.</p>	<p>Mësimdhënësi e shfrytëzon tërë kohën e disponueshme në aktivitetet mësimore përkatëse që lidhen me lëndën.</p> <p>DHE</p> <p>Gjatë gjithë mësimin, nxënësit kanë kohë të mjaftueshme për t’i përfunduar aktivitetet (mjaftueshëm, por jo të tepërt)</p>	<p>Të gjitha kushtet e “Kënaqshëm” janë përmbushur.</p> <p>DHE</p> <p>Mësimdhënësi shpenzon kohë të mjaftueshme për të dhënë udhëzime, për ta filluar një aktivitet të ri ose për shpjegime. Nuk është vërejtur asnjë veprim i tepërt ose i panevojshëm.</p> <p>DHE</p> <p>Ka mjaft kohë për mbylljen e mësimin ku nxënësit mund të reflektojnë atë që është mësuar.</p>	<p>Të gjitha kushtet e “Mirë” janë përmbushur.</p> <p>DHE</p> <p>Mësimdhënësi ofron aktivitete plotësuese për nxënësit që e përfundojnë shumë shpejt. Këto aktivitete kanë lidhje të qartë me përmbajtjen e punuar në mësim.</p> <p>OSE</p> <p>Mësimdhënësi ofron mjete konkrete për nxënësit në mënyrë që ta rregullojë vetë kohën e kaluar në një aktivitet ose pjesë të tij.</p>

(Shëno kutinë e duhur):

Jo e dukshme	Kënaqshëm	E mirë	E shkëlqyeshme
0.5	1	2	2.5
Dëshmi për pikët:			

Dimensioni 3: Angazhimi i nxënësve në aktivitetet mësimore

Pakënaqshëm	Kënaqshëm	Mirë	Shkëlqyeshëm
Asnjë kusht i “Kënaqshëm” nuk është plotësuar.	Të gjithë nxënësit janë të përfshirë në aktivitetet mësimore gjatë gjithë mësimit. DHE Mësimdhënësi u kushton vëmendje kërkesave të nxënësve dhe monitoron zhvillimin e duhur të detyrave.	Mësimdhënësi përdorë strategji të suksesshme për ta promovuar pjesëmarrjen e çdo nxënësi në aktivitetet mësimore gjatë gjithë mësimit. DHE Mësimdhënësi u kushton vëmendje kërkesave të nxënësve dhe zhvillon monitorimin e vazhdueshëm të zhvillimit të duhur të detyrave. DHE Mësimdhënësi promovon ndërveprimin midis nxënësve përmes aktiviteteve si puna në grupe, bashkëvlerësimi, ose komentimi, analizimi ose reflektimi mbi detyrat e nxënësve të tjerë, ndër të tjera.	Të gjitha kushtet e “Mirë” janë përmbushur. DHE Mësimdhënësi organizon grupet dhe punën në grup për ta maksimizuar mundësinë që çdo nxënës të merr pjesë DHE Mësimdhënësi përmend në mënyrë eksplicite rëndësinë e përfshirjes në aktivitete. OSE Të paktën në një rast mësimdhënësi e përmend rëndësinë e përpjekjes dhe të këmbënguljes. OSE Gjatë punës në grup mësimdhënësi shpreh qartë që nxënësit të kenë role të ndryshme brenda grupit.

(Shëno kutinë e duhur):

Jo e dukshme	Kënaqshëm	E mirë	E shkëlqyeshme
0.5	1	2	2.5

Dëshmi për pikët:

Dimensioni 4: Strukturimi i situatave mësimore kuptimplota

Pakënaqshëm	Kënaqshëm	Mirë	Shkëlqyeshëm
<p>Asnjë kusht i “Kënaqshëm” nuk është plotësuar.</p> <p>OSE</p> <p>Në fillim të mësimin mësimdhënësi ua jep nxënësve udhëzimet për detyrën e parë.</p>	<p>Në fillim të mësimin mësimdhënësi: Tregon se çka do të ndodhë në mësim. Tregon qëllimet e mësimin.</p> <p>DHE</p> <p>Në fund të mësimin mësimdhënësi: Liston konceptet ose aktivitetet e zhvilluara në mësim</p> <p>OSE</p> <p>I përsëritë qëllimet mësimore të mësimin</p> <p>OSE</p> <p>I thekson disa koncepte ose përmbajtjen e mësimin.</p>	<p>Mësimi fillon me përcaktimin e kontekstit të mësimin dhe/ose një eksplorim se si mësimi përshtatet me atë që tanimë e kanë mësuar).</p> <p>DHE</p> <p>Aktivitetet e planifikuara përdorin mjete dhe strategji të ndryshme mësimore për ta udhëhequr drejtpërdrejt të mësuarit e koncepteve përkatëse.</p> <p>DHE</p> <p>Në fund të mësimin, mësimdhënësi i thekson konceptet e mësuara</p> <p>OSE</p> <p>ndihmon nxënësit që ta përmbyllin duke i përmbledhur ose shpjeguar atë që kanë mësuar.</p> <p>PËRVEÇ KËSAJ</p> <p>Mësimi bën që nxënësit të përdorin teknologji të përshtatshme dhe</p>	<p>Të gjitha kushtet e “Mirë” janë përmbushur.</p> <p>DHE</p> <p>Në fund të mësimin, mësimdhënësi bën lidhje midis përmbajtjes së mësimin dhe përmbajtjes së njësive të mëparshme ose të ardhshme.</p> <p>OSE</p> <p>Mësimdhënësi në mënyrë eksplicite i bën lidhjet në mes të përmbajtjes ose shkathësive që përveçohen nga mësimi, me jetën e përditshme.</p>
		aktuale për ta rritur nivelin e të nxënit (nëse nuk është në dispozicion në shkollë, ju lutem shënoni më poshtë).	

(Shëno kutinë e duhur):

Jo e dukshme	Kënaqshëm	E mirë	E shkëlqyeshme
0.5	1	2	2.5

Dëshmi për pikët:

Dimensioni 5: Zhvillimi i të kuptuarit të nxënësve

Pakënaqshëm	Kënaqshëm	Mirë	Shkëlqyeshëm
Asnjë kusht i “Kënaqshëm” nuk është plotësuar.	Mësimdhënësi e prezanton përmbajtjen duke ndjekur një shteg koherent në përputhje me qëllimet mësimore të mësimin. Nëse është e nevojshme, mësimdhënësi e bën një demonstrim. DHE Aktivitetet mësimore kërkojnë që nxënësit të zbatojnë rregulla të përgjithshme për situata të veçanta (logjika deduktive) DHE Nxënësit kanë mundësi që t’i praktikojnë konceptet ose aftësitë që mësohen në mësim.	Mësimdhënësi e prezanton përmbajtjen duke ndjekur një shteg të saktë dhe koherent në përputhje me qëllimet mësimore të mësimin. DHE Nxënësit duhet të zbatojnë rregulla të përgjithshme për situata të veçanta (logjika deduktive). Nxënësit kanë mundësi që t’i ushtrojnë detyrat dhe t’i përshtasin ato në situata që janë të njohura për ta. DHE T’u qasen detyrave duke i përdorur aftësitë e mendimit kritik.	Mësimdhënësi e prezanton përmbajtjen duke ndjekur një shteg të saktë dhe koherent në përputhje me qëllimet mësimore të mësimin. DHE Nxënësit duhet të zbatojnë rregulla të përgjithshme për situata të veçanta (logjika deduktive) DHE Nxënësit në mënyrë aktive ballafaqohen me konceptet për ta zbuluar dhe shpjeguar një rregull të përgjithshëm nga gjetjet e tyre nga aktiviteti hulumtues (logjika induktive). OSE Mësimdhënësi u kërkon nxënësve që të reflektojnë, përshkruajnë, shpjegojnë, sintetizojnë, konkludojnë, bëjnë lidhje (krahasojnë, klasifikojnë, kategorizojnë), analizojnë, justifikojnë ose transferojnë përmbajtjet ose konceptet e mësuara.

(Shëno kutinë e duhur):

Jo e dukshme	Kënaqshëm	E mirë	E shkëlqyeshme
0.5	1	2	2.5

Dëshmi për pikët:

Dimensioni 6: Vlerësimi i mësimnxënies nga nxënësit

Pakënaqshëm	Kënaqshëm	Mirë	Shkëlqyeshëm
Asnjë kusht i “Kënaqshëm” nuk është plotësuar.	<p>Çdo aktivitet i plotëson kushtet e mëposhtme.</p> <ul style="list-style-type: none"> Mësimdhënësi kontrollon se nxënësit e kanë kuptuar: duke i pyetur nxënësit vazhdimisht gjatë prezantimit. duke monitoruar zhvillimin e duhur të të gjitha aktiviteteve duke iu përgjigjur pyetjeve të nxënësve me saktësi. 	<p>Çdo aktivitet i plotëson kushtet e mëposhtme.</p> <ul style="list-style-type: none"> Mësimdhënësi kontrollon se nxënësit e kanë kuptuar: Duke përdorur një shumëllojshmëri të vlerësimeve (pyetje me teste me shkrim të ndryshëm të kompleksitetit, revista të nxënësve, projekte ose produkte etj.) Duke monitoruar përgjigjet e nxënësve në të gjitha aktivitetet. duke iu përgjigjur pyetjeve të nxënësve me saktësi. Identifikimi dhe menaxhimi i drejtë i keqkuptimeve ose pyetjeve të nxënësve. 	<p>Të gjitha kushtet e “Mirë” janë përmbushur.</p> <p>DHE</p> <ul style="list-style-type: none"> Mësimdhënësi promovon aftësinë e nxënësve për të reflektuar dhe vlerësuar procesin e tyre të të mësuarit dhe të arritjeve.

(Shëno kutinë e duhur):

Jo e dukshme	Kënaqshëm	E mirë	E shkëlqyeshme
0.5	1	2	2.5

Dëshmi për pikët:

Dimensioni 7: Zhvillimi i autonomisë

Pakënaqshëm	Kënaqshëm	Mirë	Shkëlqyeshëm
Asnjë kusht i “Kënaqshëm” nuk është plotësuar.	<p>Gjatë mësimit, mësimitdhënësi në mënyrë eksplicite u mundëson nxënësve që t’i kryejnë veprimet e mëposhtme:</p> <p>Zgjedhin midis ushtrimeve ose detyrave të ndryshme ose rritjes së numrit të detyrave për t’u zgjidhur.</p> <p>Zgjidhni mënyrën si t’i prezentoni zgjedhjet e tyre (d.m.th.: me gojë, me shkrim, në grafik ose ilustrim)</p> <p>Monitoron punën e tyre duke e përdorur një listë kontrolli.</p>	<p>Gjatë mësimit, mësimitdhënësi në mënyrë eksplicite u mundëson nxënësve që:</p> <p>T’i eksplorojnë zgjedhjet e veta në një hulumtim të udhëhequr</p> <p>DHE</p> <p>Promovon cilindo nga veprimet e mëposhtme të nxënësve:</p> <p>Zgjedhin si të punojnë brenda grupit</p> <p>Identifikojnë strategjitë e përdorura për ta zgjidhur një detyrë.</p> <p>Monitoron punën e tyre duke e përdorur një listë kontrolli ose ndonjë udhëzim tjetër.</p> <p>Sfidojnë njëri-tjetrin teksa eksplorojnë zgjedhjet.</p>	<p>Gjatë gjithë mësimit, mësimitdhënësi në mënyrë eksplicite u mundëson nxënësve që t’i përmbushin kërkesat nën ‘Mirë’</p> <p>DHE cilëndo nga të mëposhtmet:</p> <p>Manipulojnë vet materialet për t’i gjetur zgjedhjet e problemeve.</p> <p>Eksplorojnë zgjedhjet vetjake dhe mendojnë në mënyrë të pavarur në hetim të hapur ose origjinal para se të vinë në përfundime</p> <p>Marrin detyra më komplekse ose të vështira plotësuese nëse e kanë përfunduar detyrën shumë shpejt.</p>

(Shëno kutinë e duhur):

Jo e dukshme	Kënaqshëm	E mirë	E shkëlqyeshme
0.5	1	2	2.5

Dëshmi për pikët:

Shtojca C - Poentimi përfundimtar - raporti i vlerësimit të mësimitdhënës

Emri i mësimitdhënës _____

Numri i mësimitdhënës _____

(Vendose rezultatin përfundimtar në kutinë e duhur)

Pakënaqshëm	Kënaqshëm	Mirë	Shkëlqyeshëm
Më pak se 11	11-13.5	14-15.5	16-17.5

Komentet dhe/ose fushat që kanë nevojë për përmirësim: (shënoji numrin e pikëve dhe një arsyetim për çdo dimension)

Dimensioni # 1

Dimensioni # 2

Dimensioni # 3

Dimensioni # 4

Dimensioni # 5

Dimensioni # 6

Dimensioni # 7

Ja kam prezentuar këtë raport mësimdhënësit dhe ia kam shpjeguar rezultatet që përmbahen aty.

Emri i inspektorit

Data

E kam pranuar këtë raport, e kam lexuar përmbajtjen e tij dhe ma kanë shpjeguar atë.

(Nënshkrimi i këtij dokumenti nuk nënkupton pajtim me konkluzionet e tij, por thjesht nënkupton se keni pasur mundësinë që ta shqyrtoni).

Emri i mësimdhënësit

Data

Shkolla

ID e mësimdhënësit



Kosovo Legal
Services Company

IBE



EDUCATIONAL
RESEARCH
INSTITUTE



Ky dokument u prodhua me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe partnerëve të konsorciumit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.